

KDU 28 (05)

821.411.21 (05)

ISSN (Print) 2663-3965

ISSN (Online) 2663-3973

Instituti për Studime Orientale

Republika e Kosovës

Studime Orientale

Revistë shkencore

International Academic Journal

Uluslararası Bilimsel Araştırmalar Dergisi

Volume 4

Prishtinë, 2019

Lektor

Prof. Ass. Dr. Xhevat Syla

Dizajneri i kopertinës

Edib Agagjyshi

Stamboll - Turqi

Faqosja dhe përpunimi teknik

Amal Ganim

Amman - Jordani

Shypshkronja "Timegate"

Prishtinë - Kosovë

Stafi i revistës / The Journal Staff

Kryeredaktor / Editor in Chief

Prof. dr. Muhamed Mufaku

Zv.kryeredaktor / Deputy editor in Chief

Prof. dr. Abdullah Hamiti

Sekretar i Redaksisë / Secreter

Prof. ass. dr. Abdulla Rexhepi

Bordi redaktues / Editorial Board

Prof. Dr. Salah Jarar, Jordan

Prof. Dr. Tatjana Paić - Vukić, Croatia

Prof. assoc. Dr. Munir Mujić, Bosna & Herzegovina

Prof. assoc. Dr. Nuran Malta, Kosovo

Prof. assoc. Dr. Isa Memishi, Kosovo

Prof. assoc. Dr. Xhemile Abdiu, Albania

Prof. assoc. Dr. Nehat Krasniqi, Kosovo

Phd. Cand. Zeqije Xhafçe, Kosovo

**Bordi konsultativ ndërkombëtar /
International Advisory Board**

Prof. Dr. Nathalie Clayer, France

Prof. Dr. Ayman Fuad Sayid, Egypt

Prof. Dr. Özkul Çobanoğlu, Turkey

Prof. Dr. Fazıl Bayat, IRCICA

Prof. Dr. Gholamhussein Gholamhusseinzadeh, Iran

Prof. assoc. Dr. Ludmila Yaneva, Bulgaria

Prof. Dr. Ibrahim Sadaoui, Tunis

Prof. assoc. Dr. Marcus Lucullus, Poland

Kushte për botim

Revistën Studime Orientale e boton Instituti për Studime Orientale (ISO) në Prishtinë, i cili është institucion joqveritar dhe jo profitabil. Redaksia e revistës Studime Orientale mirëpret punimet për botim në gjuhët e akredituara në revistë (shqip, anglisht, turqisht, persisht dhe arabisht). Punimet duhet të paraqesin kontribute origjinale në fushën e orientalistikës në Kosovë, Ballkan dhe më gjerë. Po ashtu, revista mirëpret recensione të botimeve të reja, të botuara brenda pesë viteve të fundit, deri në 1500 fjalë.

Punimet deri në shtatë mijë fjalë dërgohen në Word me një abstrakt me katër fjalë kyçe, si dhe me rezyme në gjuhën angleze. Nëse punimi është në anglisht, abstrakti mund të jetë në një gjuhë tjetër të akredituar në revistë (shqip, turqisht, persisht apo arabisht). Punimet e recensionet dërgohen në adresën:

revista.studimeorientale@gmail.com

Punimet e paraqitura për botim duhet të jenë origjinale, pra që nuk janë botuar pjesërisht ose tërësisht, por mund të botohen në një gjuhë tjetër të revistës me pelqimin e Redaksisë.

Punimet e botuara në revistë nuk mund të kopjohen në asnjë formë, të ruhen në një bazë të dhënash ose të riprodhohen pa lejen e botuesit, kurse lejohen citime sipas kritereve shkencore.

Conditions of publication

Oriental Studies Journal is published by the Institute for Oriental Studies in Pristina, which is a non-governmental and nonprofit institution, as such welcomes the publication works in accredited languages in the magazine (Albanian, English, Turkish, Persian and Arabic), which represent original contributions in the field of orientalistcs in Kosovo, the Balkans, and beyond. Also the magazine welcomes reviews of new publications, published in the last five years, up to 1500 words.

Works up to 7, 000 words, are sent in Word format with four-key words, as well as a resume in English, and if it's in English, the resume can be in another accredited language in the journal (Albanian, Turkish, Persian and Arabic). Works and reviews are sent in add:

revista.studimeorientale@gmail.com

The articles submitted for publication should be original, so that they were not published in part or in full, but may be some articles republished here in other languages (in English, Arabic etc.) with the permission of the authors.

Works published in the journal cannot be copied in any form, stored in a database or reproduced without the permission of the publisher, citations are allowed according to scientific criteria.

Përmbajtja / Contents

FJALA E REDAKSISË / EDITORIAL	1-17
(Albanian Section)	
Isa Memishi FJALORI HISTORIK I ARABISHTËS I DOHËS DOHA'S/ HISTORICAL ARABIC DICTIONARY	19-47
Abdulla Rexhepi ARISTOTELE NË MEDRESETË SHQIPTARE/ ARISTOTELE IN ALBANIAN MADRASAS	49-70
Recensione	
Nehat Krasniqi, ZHVILLIMI I KULTURËS SHQIPTARE ME NDIKIME ORIENTALE PREJ SHEKULLIT XVIII DERI NË FILLIMET E RILINDJES KOMBËTARE (Muhamed Mufaku)	71-74
Amina Šiljak-Jesenković, ODRAZI LJUBAVNIH MESNEVIJA U STIHOVIMA BOŠNJAČKIH DIVANSKIH PJESNIKA, Orijentalni Institut u Sarajevu (Zeqije Xhafçe)	75-78
In Memoriam	
MEHMET KICO 1949-2018 (Feti Mehdiu)	79-83
QEMAJL MORINA 1951-2019 (Ejup Ramadani)	85-87
(English Section)	
Esad Duraković POETRY UNDER THE PROFET'S MANTLE POEZIA NËN GUNËN E PROFETIT	89-107
Book Reviews	
EPITAPHS IN OTTOMAN LANGUAGE IN THE REGION OF PRISTINA (Nedim Zahirović)	109-111

In Memoarium

DARIUSH SHAYEGAN 1935-2018 (Abdulla Rexhepi) 113-116

(Turkish Section)

Fatma Shehu
ARNAVUTLUK GURI-BARDH KÖYÜNÜN GELENEKSEL
KIYAFETLERİ 117-138
THE ALBANIAN TRADITIONAL CLOTHES OF GURI-
BARDH VILLAGE

Kitap Tanıtımı

M. Öcal Oğuz, PALDIR KÜLTÜR KENTLEŞMELER.
Ankara: Geleneksel Yayıncılık (Mehmet Daldal) 139-143

(Arabic Section)

Muhamed Mufaku, Abdul-Hameed Al-Kayyali, Hassan Hassan
MEHDI BEY, GOVERNOR OF OTTOMAN JERUSALEM
IN 1912 - NEW PERSPECTIVE OF ARAB AND JEWS
ATTITUDES TOWARDS HIM 13-46

Skender Gashi
THE "EGYPTIANS" IN KOSOVO 47-60

Book reviews

NEW TOW TRANSLANTIONS OF IBN HALDUN'
MUQADDIMA IN ALBANIAN LANGUAGE 61-64

(Persian Section)

Hussainali Ghobadi, Marym Sadeghi, Maryam Sharif Nasab
SAADI SHIRAZI AND CHALLENGES OF
CONTEMPORARY PEOPLE 73-99

Fjala e redaksisë

Ky numër i revistës *Studime Orientale* po del më ndryshime krahasuar me numrat e kaluar, në saje të ndryshimeve institucionale në organizimin e studimeve orientale që janë bërë gjatë viteteve të fundit. Numrat e parë të revistës 1-3 u botuan nga Shoqata e Orientalistëve të Kosovës (SHOK), e cila u themelua më 2006. Kjo shoqatë e botoi më vonë revistën *Studime Orientale* në gjuhën shqipe, e cila i dedikohet rrethit të interesuar për këtë fushë studimesh në botën shqiptare.

Me themelimin e Institutit për Studime Orientale (ISO) në Prishtinë, më 2016, në marrëveshje me kolegët e Shoqatës së Orientalistëve në Kosovë, të cilët tani janë të angazhuar edhe në Institut (ISO), edhe në revistë, u dakordua që të vazhdohet me botimin e revistës *Studime Orientale*, si botim i Institutit (ISO), me qëllim që të mbahet kontinuiteti i punës profesionale në fushën e orientalistikës në Kosovë, e cila daton së paku që nga viti 1973, kur edhe u themelua Dega e Orientalistikës në Universitetin e Prishtinës.

Në përputhje me Statutin e Institutit (ISO), Bordi i ri i Institutit e ka parë të udhës që numri i ri i revistës (nr. 4) të dalë në pesë gjuhë (nga e majta - në shqip, anglisht e turqisht, kurse e nga e djatha - në arabisht e persisht). Kjo mënyrë e botimit të revistës është menduar të jetë urë komunikimi midis kolegëve që merren me studimet orientale në Ballkan dhe të gjithë atyre që janë të interesuar për këto studime në Lindje dhe në Përendim. Pikërisht për këtë, tani e

tutje në këtë revistë do të botohen punime origjinale në këto gjuhë, por edhe punime të përkthya, me pelqimin e autorëve dhe të institucioneve përkatëse.

Po ashtu, tani e tutje revista do të botojë recensione për veprat e reja (deri në 1500 fjalë), të botuara në gjuhë të ndryshme të Ballkanit e që paraqesin vlerë dhe meritojnë të prezantohen në rrethe më të gjera në gjuhët në të cilat botohet revista.

Kështu, në këtë numër, në pjesën e majtë kemi punime në gjuhët angleze, shqipe dhe turke. Në gjuhën shqipe kemi një punim që i dedikohet një ngjarjeje shkencore të shumëpritur deri tani, botimit të Fjalorit historik të gjuhës arabe. Në këtë punim autori është përpjekur të prezantojë një sistem profesional të transkriptimit të emrave arabë në gjuhën shqipe, që mund të jetë iniciativë për një konsultë në nivel mbarëshqiptar për një sistem të unifikuar, të cilin ende nuk e kemi krahas gjithë kësaj tradite të punës që kemi në orientistikë. Gjithashtu, në gjuhën shqipe botohet edhe një studim për logjikën e Aristotelit, e cila mësohej në medresetë shqiptare deri në gjysmën e dytë të shekullit XX. Në seksionin në gjuhën angleze kemi një studim për qëndrimin e Profetit Muhammad ndaj poezisë, kurse në seksionin në turqishte kemi një punim për veshjet popullore në fshatin GuriBardhë në Shqipëri deri në shek. XV, përkatësisht deri në pushtimin osman. Në pjesën e djathtë, në seksionin e gjuhës arabe, kemi një studim për Mehdi Frashërin për kohën derisa ishte guvernator i Jerusalemit më 1912, si dhe një studim të përkthyer nga shqipja në

arabisht për fenomenin e "egjiptianëve të Kosovës". Më në fund, në sesionin në gjuhën perse kemi një punim që i kushtohet poetit Sadi dhe sfidave të njeriut bashkëkohor.

Përveç recensioneve për vepra të ndryshme, në këtë numër të revistës kemi edhe rubrikën *In Memoariam*, me ç'rast përkujtojmë dhe nderojmë Dariush Shayegan (1935 -2018), Mehmet Kico (1949 -2018) dhe Qemajl Morina (1951 -2019).

Kemi nderin të njoftojmë lexuesit dhe opinionin e gjerë se gjatë përgatitjes për botim të këtij numri të revistës, anëtari i Bordit konsultativ i Institutit (ISO) Akad. Esad Duraković u nderua me Çmimin për përkthim e mirëkuptim ndërkombëtar për veprën jetësore që përfshin përkthimet e tij nga gjuha boshnjake në arabisht (Doha 2018), kurse anëtari i redaksisë Salah Jarrar, në janar të vitit 2019, u nderua me Medaljen Mbretërore Spanjolle për veprën jetësore në fushën e studimeve arabe-spanjolle.

Prof. Muhamed Mufaku

Editorial

This new issue of the Oriental Studies Journal comes differently compared to its previous numbers due to the institutional changes that have taken place over the last few years. The first issue of 1-3 was published by the Association of Orientalists of Kosovo (SHOK), which was founded in 2006 and later published the Oriental Studies Journal in Albanian. It was dedicated to the circle of interested readers in this area in Albanian world. With the founding of the Institute for Oriental Studies (ISO) in Pristina, in 2016, we have agreed with our colleagues from the Association of Orientalists of Kosovo who are now present at the Institute (ISO) and in the Journal, to continue publishing the magazine Oriental Studies as a publication of the Institute (ISO) to maintain the continuity of professional work in the field of oriental studies in Kosovo, which dates back to at least from 1973 with the foundation of the Department of oriental studies at the University of Pristina.

In line with the Statute of the Institute (ISO), the new Board of the Institute decided at the end of 2018 that the new edition of the journal would be published in five languages (from left in Albanian, English, Turkish and from right in Arabic and Persian) in order to be a bridge of communication between colleagues dealing with Oriental studies in the Balkans and those who are interested in these studies in the East and in the West. For this reason now on original works in

these languages , or translated works in these languages with the consent of the respective authors and institutions, will be published in the Journal. Also, from now on the Journal will take care to publish book reviews of new books (up to 1500 words) published in different Balkan languages that represent value and deserve to be presented in the broader circle through the languages accredited in the journal.

Thus, in this number we have on the left, or in the English, Albanian and Turkish studies section, a study in English on the Prophet Muhammad's attitude to poetry, while in Albanian we have a study for a long-awaited scientific event: the publication of the Historic Dictionary of the Arabic language in Doha in 2018. Another study in this section is about the logic of Aristotle in the Albanian madrasas, while in Turkish we have a survey of folk costumes in the village Gurri-Bardhë in Albania. On the right side, or in the Arabic and Persian languages section, we have a study about Mehdi Frashëri as a Governor of Jerusalem in 1912, and a study translated from Albanian about the phenomenon of "Egyptians of Kosovo", while in Persian we have a work about the poet Sadi and the challenges of modern man.

In addition to the book reviews in this number we will have the **In Memoriam** for the distinguished figures that range between the two Journal numbers. Thus, in this issue will be honored with note DariushShayegan (1935-2018), Mehmet Kico (1949 -2018) and

Qemajl Morina (1951-2019). Also we're delighted with the award given to the member of our Institutes consultative board (ISO) Acad. Esad Durakovic, who was honored with Prize for translation and international understanding in Doha, for his life work involving his translations from Bosnian to Arabic (Doha 2018), while editorial board member Prof. Salah Jarrar was honored in January 2019 with the Royal Spanish Medal for the life work in the Arab-Spanish studies field.

Prof. Muhamed Mufaku

**Fjalori historik i arabishtes i Dohas -
kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore**

Isa Memishi*

Abstrakt

Leksikografia ndër arabët ka një traditë mjaft të hershme dhe të bujshme. Edhe pse fjalori i parë i arabishtes ishte hartuar që në shekullin e VIII nga Həlil Bin Ahmād Bin əl-Fārəhīdij, u desh të pritet shekulli XXI që të kemi fjalorin historik të arabishtes.

Ide për hartimin e një fjalori historik të gjuhës arabe kishte edhe më herët. Ndër iniciativat më serioze për hartimin e një fjalori të këtyre përmasave është ai i Akademisë së Gjuhës Arabe në Kajro, në vitin 1932. Një nismë tjetër për hartimin e fjalorit historik të arabishtes ka qenë ajo e orientalistit gjerman August Fischer në vitin 1913. Pas kësaj kemi nismën e Abdulla əl-‘Aləjlī në Liban. Një projekt tjetër për hartimin e fjalorit historik të gjuhës arabe ka qenë edhe projekti i Asocionit të Akademisë së Gjuhës Arabe dhe Shekncave në Tunizi.

Gjithë këto përpjekje nuk u jetësuan, nuk rezultuan me ndonjë sukses konkret për të pasur Fjalorin historik të gjuhës arabe të plotë. Nga Fjalori i Fischerit, dritën e botimit e pa vetëm vëllimi iparë, i botuar më 1967 në Kajro dhe ai i Abdulla əl-‘Aləjlīt me vetëm një vëllim të botuar më 1963.

Projektin e shumëpritur për Fjalorin historik të arabishtes, më 25 maj 2013 e lansoi Qendra Arabe për Kërkime në Doha me një ekip në krye me Rəmzi Ba‘lābākun, kurse përfundimin e etapës së parë, nga tri gjithsej, e promovoi në dhjetor të vitit 2018.

Fjalët kyeçe. Fjalori historik i arabishtes, Doha, Fischeri, Akademia e Gjuhës Arabe.

* Profesor i gjuhës arabe në Degën e Orientalistikës në F. Filologjik të Universitetit "Hasan Prishtina" në Prishtinë, autor i *Fjalorit arabisht-shqip* (2011).

Hyrje

Fjalorët historikë dallojnë nga fjalorët e zakonshëm. Derisa këta të fundit japin sqarime rreth kuptimit të një fjale të caktuar, pa u ndalur në historikun e asaj fjale dhe në evoluimin e kuptimit të saj, fjalorët historikë ofrojnë të dhëna se kur për herë të parë është përdorur një fjalë e caktuar, kuptimi i parë i saj dhe transformimi semantik dhe strukturor. Fjalorët historikë regjistrojnë gjithë trashëgiminë leksikore të teksteve, qofshin ato të gdhendura apo të regjistruara në tekstet e vjetra. Pikërisht kjo është vlera e këtyre fjalorëve. Fjalorët historikë prezantojnë leksikun me mjete racionale.

Një çështje që është diskutuar ndër leksikografët arabë është ajo se cila është gjuha letrare arabe dhe, në kuadër të saj, cili duhet të jetë leksiku që duhet të prezantohet në fjalorët historikë?

Sipas August Fischerit, atëbotë edhe arabologët më të njohur ende nuk ishin të një mendjeje se cila arabishte ishte për ta arabishtja letrare.¹ Sipas pjesës dërmuese të historianëve të gjuhës arabe, arabishte letrare konsiderohej i gjithë leksiku që mund të dëshmohej, duke e ndarë në tri fusha:

1. Leksiku i Kuranit, duke e besuar si fjalë të Perendisë së lartëmadhërishtë;
2. Leksikun e hadithit, duke e besuar fjalë të Profetit Muhamed;
3. Leksiku i klasikëve arabë. Në këtë fushë është përfshirë i gjithë leksiku i veprave të sistemuara apo të pasistemuara nga klasikët.

Në grupin e klasikëve janë përfshirë tri gjenerata.

¹ أ. فيشر، المعجم اللغوي التاريخي، القاهرة، ١٩٧٦، ص ٧.

1. Gjenerata e parë është gjenerata e poetëve të periudhës paraislame, si si'Imru'u-l-Ķajs e të tjerë;
2. Gjenerata e poetëve që kanë jetuar në periudhën paraislame dhe në atë islame;
3. Gjenerata e poetëve të quajtur poetë islamë, që nuk kanë jetuar në periudhën paraislame.
4. Gjenerata e poetëve pas klasikëve e deri në ditët tona, ndryshe këta poetë quhen edhe poetë bashkëkohorë. Në këtë gjeneratë përfshihen poetët duke filluar nga Bâshâr Bin Burd, Ebu Nuvâs e të tjerë.

Fischer e përkrah mendimin e Abu Naşr âl-Fârâbî (874-950), të shfaqur në hyrje të veprës së tij *Kitābu-l-hurūf*, ku thotë: Kurejshitet janë arabët më të qartë në theks, janë arabët që më së lehti shqiptojnë arabishten, gjuha e tyre është më e bukura për veshin, duke vazhduar se, nga ky fis janë edhe autorët klasikë si'Imru'u-l-Ķajsi, Tâmiimi dhe të tjerët.² Fischer, duke vlerësuar pjesën më të madhe të leksikut të gjuhës së poezisë klasike, shkon edhe më larg duke e quajtur atë varietet edhe *Lingua franca poetica*.

Për të dhënë një pasqyrë rreth zhvillimit të hartimit të fjalorit historik të arabishtes, së pari duhet parë zhvillimin e leksikografisë arabe.

Sipas historianëve të historisë së gjuhës arabe, shkollat më të rëndësishme të leksikografisë arabe janë katër:³

² أ. فيشر، المرجع السابق، ص ١٢.

³ دكتور عبد الحميد محمد أبو سكين، المعاجم العربية مدارسها ومناهجها، جامعة الأزهر، ١٩٨١، الطبعة الثانية ص ٢٦-٢٨.

Shkolla e parë e leksikografisë arabe

Fjalor i parë i gjuhës arabe konsiderohet "*Kitābu-l-ʿAjn*", me autor Ḥalīl Bin Ahmed Bin âl-Fârāhīdij (718-786). âl-Ḥalīl Bin ʿAhmed konsiderohet pionier në fushën e leksikografisë arabe dhe njihet si themelues i shkollës së parë në leksigrafinë arabe. âl-Ḥalīl, sipas Fisherit, për shekuj me radhë është konsideruar ndër filologët më të njohur në historinë e arabistikës. Ai gjithashtu konsiderohet edhe themelues i metrikës arabe dhe i arabistikës.⁴

Ajo që e bën karakteristik fjalorin e tij nga fjalorët e traditës arabe, është sistemi i renditjes së fjalëve. Renditja alfabetike e këtij fjalori është bërë sipas vendshqiptimit të konsonanteve të alfabetit arab, një traditë e renditjes së alfabetit të sanskritishtes. Ai renditjen e fjalëve në fjalor e fillon me konsonantet grykore, e pastaj me ato qiellëzore, për të vazhduar me dentalet dhe më në fund me konsonantet buzore.

Ky sistem i renditjes alfabetike njihet njëherësh edhe si shkolla e parë në leksikografinë arabe. Këtë sistem e ndoqën edhe disa autorë të tjerë pas âl-Ḥalīl Bin ʿAhmedit, siç janë: Âbu ʿAlī al-Ḳālī (901 - 967) me veprën *âl-Bāri ʿu*;⁵ Âbu Mânşūr âl-ʿÂz'hârij (895-981) me veprën *Tâhdhību-l-luga*;⁶ Âbu Bâqr Bin âl-Ḥasan âz-Zubâjdī âl'Ishbīlī (vdiq më 989) me veprën *Muḥtâşâru-l-ʿajni*; Şāhib Bin ʿIbāde (935-985) me fjalorin e tij *âl-Muḥīṭ fī-l-luga*⁷ dhe Ibn Sâjjid (1007-1066) me fjalorin *âl-Muxhem vâ-l-muḥīṭul-l-ʿa ʿzam*.

⁴ أ. فيشر، المرجع السابق، ص ٤.

⁵ لمزيد من التفاصيل: دكتور حسين نصار، المعجم العربي نشأته وتطوره، الجزء الأول، دار المصر للطباعة، ١٩٨٨، ص ١٤٥.

⁶ الجوهري، الصحاح، الجزء ١، تحقيق أحمد عبد الغفور العطار، الطبعة الرابعة ١٩٨٧، دار العلم للملايين، لبنان، ص ٨.

⁷ دكتور حسين نصار، المرجع السابق، ص ٣٣٢.

Shkolla e dytë e leksikografisë arabe

Themelues i shkollës së dytë të leksikografisë arabe njihet Ibn Durâjdi (837-933) me vepërën e tij *Xhâmhârâ*. Ky autor ndjek sistemin e renditjes së fjalëve sipas një parimi krejt tjetër nga shkolla e parë e leksikografisë arabe. Sa për ilustrim, po përmendim fjalën *عجم* /'axhâmâ/ të cilën e rendit tek konsonanti *ج/xh/* duke u bazuar në parimin se konsonanti *ج/xh/*, sipas renditjes alfabetike, nga tri konsonantet bazike, është konsonanti i parë në alfabetin arab.⁸

Shkolla e tretë e leksikografisë arabe

Shkolla e tretë e leksikologjisë arabe konsiderohet shkolla e ashtuquajtur *Shkolla kafije*. Themelues i kësaj shkolle konsiderohet âl-Fârâbî, me vepërën e tij *Divānu-l-âdâb*. Për dallim nga dy shkollat e para, ky autor ndjek një metodë të veçantë në renditjen fjalëve në fjalor. âl-Fârâbî fjalorin e tij e ndan në kapituj. Rënditjen e kapitujve e bën sipas renditjes alfabetike tradicionale në leksikologji, por që fjalët i rendit duke marrë konsonantin e fundit të asaj fjale. Fjalën *بحث* /bâḥathâ/ e rendit te kapitulli i konsonantit *ث/th/*. Ky sistem i kërkimit të fjalëve në fjalor konsiderohet ndër më të zorshmit.

Këtë shkollë të leksikografisë e ndoqën âl-Xhâvhârî (vdiq më 1003) me vepërën e tij *aṣ-suḥāḥā*. Kësaj shkolle i përkasin Ibn Mânzûr (1232-1311) me vepërën e tij *Lisāni-l-ʿarab*; Fâjrûz ʿĀbādî (1328-1414) me vepërën *âl-Kāmusu-l-muḥīṭ* dhe âz-Zubâjdî (1732-1790) me vepërën *Tāxhul-l-ʿarūs*.

⁸ د. علي محمود الصراف، أصول المعجم العربي، المجلة الأردنية في اللغة العربية وآدابها، المجلد (٩)، العدد (٤)، ٢٠١٤، ص ١٨٣.

Shkolla e katërt e leksikografisë arabe

Themelues i kësaj shkolle të leksikografisë konsiderohet Âbu ‘Amru -sh-Shâjbânî (728- 821) me veprën e tij *âl-Xhîm*. Renditja e fjalëve në fjalor, sipas këtij sistemi, është renditje alfabetike.

Fjalët, pasi të jenë liruar nga ndajshesat, renditen sipas rendit alfabetik.

Ky sistem i renditjes së fjalëve në fjalor është ndër më të thjeshtit dhe më lehtë i përdorshëm. Meqenëse është sistemi më praktik, prandaj edhe ka gjetur shtrirje kohore dhe deri diku është sistem standard në hartimin e fjalorëve edhe në ditët tona.

Ndjekësit më të njohur të kësaj shkolle të leksikografisë arabe janë: Ibn Fâris (941-1005) me veprën e tij *Mâkâjîsu-l-luga*,⁹ âl-Zâmaḥashârî (1074-1143) me veprën e tij *’Âsâsu-l-bâlâga*, âr-Rrazî (vdiq më 1261) me veprën e tij *Muḥtâru ’ṣ-siḥâh*, dhe fjalorët bashkëkohor si *âl-Mu ḫhâmu-l-vâṣiṭ*, *âl-Mu ḫhemu-l-vexhîz*, *âl-Mu ḫhemu-l-kâbîr* etj.

Pavarësisht faktit se leksikografia arabe kishte një të kaluar mjaft të begatshme dhe, pavarësisht asaj që u cek më lart lidhur me shkollat e leksikografisë arabe, nuk shohim ndonjë iniciativë apo përpjekje për hartimin e një fjalori historik të arabishtes. Karshi gjithë kësaj trashëgimie në leksikografi dhe veprave nga fusha e gjuhësisë, si *’Âlfijâtubnu-l-Mâlik* dhe *âl-Âxhrûmiyâ*, me autor Ibnu ’Âxhrûm, asnjë autor nuk prezantoi tekste nga gjuha klasike arabe, por gati të gjithë autorët i referoheshin njëri-tjetrit dhe citoreshin mes veti. Arabishtja kishte nevojë për një fjalor

⁹ د. علي محمود الصراف، المرجع السابق، ص ١٨٦.

historik, ku do të pasqyrohej historia e leksikut të gjuhës arabe dhe ku do të regjistrohej e gjithë ajo trashëgimi leksikore.

Iniciativa e parë për hartimin e një fjalori historik të gjuhës arabe ishte nga Akademia e Gjuhës Arabe në Kajro në vitin 1932.

Pas kësaj kemi iniciativën e Abdulla âl-‘Alājī (1914-1996) në Liban, i cili e hartoi Fjalorin historik të arabishtes të titulluar *al-Marxhi'* me 1963.

Një projekt tjetër për hartimin e fjalorit historik të gjuhës arabe ka qenë edhe ai në Tunizi, nga Asocioni i Akademisë së Gjuhës Arabe dhe Shkencave.

Një ndër iniciativat më serioze për hartimin e *Fjalorit historik të arabishtes* ka qenë ajo e orientalistit August Fischer, në vitin 1913.

Me këtë rast, shkurtimisht do të ndalemi për të parë historinë e inisiativës së August Fischerit për hartimin e fjalorit historik të arabishtes dhe projektin e Abdulla âl-‘Alājī. Përkundër faktit që këta dy autorë i kishin realizuar projektet e tyre, njëri në tërësi e tjetri gati të plotë, megjithatë dritën e botimit e panë vetëm me nga një vëllim.

August Fischeri (1865-1949), orientalist gjerman i specializuar në arabistikë në fushën e morfologjisë, sintaksës dhe leksikologjisë, ishte pasues i rrugës së profesorit të tij, filologut të madh Heinrich Leberecht Fleicher,¹⁰ i cili është edhe themelues i shkollës së njohur në orientalistikën gjermane me emrin *Shkolla e Leipsiger*. Ai ndoqi metodën që studimet të

¹⁰ Heinrich Leberecht Fleicher (1801-1888) është ndër studiuesit më të njohur të studimeve orientale në shekullin nëntëmbëdhjetë. Në arabisht ka botuar veprën "*Tarīḥ ābī āl-Fedā*", të njëjtën veper e ka përkthyer edhe në gjermanisht. Ai gjithashtu ka hartuar edhe një katalog të quajtur "Katalog i dorëshkrimeve orientale të ruajtura në Drezden". Me 1845 themeloi "Shoqatën orintalo-gjermane".

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore mbështeten në dokumente dhe në prova të arabologëve, në rend të parë, dhe në rezultatet e filologëve arabë, duke qëndruar larg supozimeve të cilat mund të jenë mahnitëse, por të pabazuara.¹¹

A. Fischer është autoritet i pakontestueshëm në studimet e gjuhëve orientale, si në arabisht, në hebraisht, në persisht, në sirianishte dhe në gjuhët e tjera.¹² Fischer ishte njohës i mirë letërsisë arabe dhe i historisë së kulturës. Ai ishte i apasionuar pas gjuhës arabe, posaçërisht pas leksikologjisë arabe. Duke u marrë me letërsinë arabe, me leximin e teksteve nga letërsia arabe, ai u thellua në leksikun e gjuhës arabe. Gjatë gjithë jetës së tij akademike, ai u përkushtua në etimologjinë e leksikut të gjuhës arabe.

A. Fischer, duke shprehur admirim për të gjithë autorët e fjalorëve të gjeneratave para tij, thotë se të gjithë autorët kishin ndjekur njëri-tjetrin dhe se tani ishte koha që të shihej se cilat ishin mangësitë e atyre fjalorëve dhe të shihej në mos ishte koha për një fjalor të ri dhe më të pasur. Fischer, pas botimit të fjalorit të Oxford (OED), fjalor i parë historik i plotë, prezantoi idenë e tij për hartimin e fjalorit historik të arabishtes.¹³

Që në fazën fillestare Fischeri shtron pyetjen se si do të dukej një fjalor i gjuhës arabe letrare i përshtatshëm për zhvillimin e arabistikës në shekullin XX? Ai, në projekt-propozimin e tij për hartimin e fjalorit historik të arabishtes, thotë: ky fjalor duhet të përfshijë gjithë leksikun e gjuhës

¹¹Për më shumë rreth jetës dhe veprës së Fischerit, shih Abdurrahman Bâdâvî, Leksikon i Orientalistëve, Logos A, Shkup, 2015, f. 31-35.

¹²مصطفى يوسف، المستعربون في خدمة العربية،

<http://www.m-a-arabia.com/vb/showthread.php?t=11416>

¹³د. علي توفيق الحمد، المعجم التاريخي العربية (مفهومه، وظيفته، محتواه)، المجلة المعجمية، ع ٥، ٦، ١٩٩٠، تونس، ص 100.

<http://mohamedrabee.net/library/pdf/c310f20a-420d-4e93-9211-1cd8f721538c.pdf>

arabe që ka gjetur, pa përjashtime, duke pasur parasysh këto kritere: kriterin historik, etimologjik, polisemik, sintaksor dhe frazeologjik. Fischeri gjithë këto kritere i shtjellon më tej në parathëniene fjalorit të tij, për të cilin do të bëjmë fjalë në vijim.

Fischeri, në raportin që e kishte prezantuar para Akademisë së Gjuhës Arabe në Kajro në vitin 1936, kishte prezantuar parimet kryesore të Fjalorit historik të arabishtes. Ai kishte prezantuar pesë parime të cilave do t'u përmbahej:

1. Struktura e përmbajtjes së fjalorit. Aty do të prezantohej burimi nga është vjelur secila fjalë;
2. Mënyra se si është vjelur materiali. Për secilën fjalë kishte skedë të veçantë, duke prezantuar strukturën dhe kuptimin e saj.
3. Strukturën e fjalorit. Në këtë pjesë kishte prezantuar renditjen e fjalëve, duke filluar nga konsonanti i parë, i dytë, i tretë, e kështu me radhë, dhe për secilën fjalë trekonsonantike duke e prezantuar atë me të gjitha derivatet e saj.
4. Rregullat kryesore të leksikografisë. Vokalizimin e secilës fjalë, verifikimin, strukturën, kuptimin, duke e argumentuar me argumente të dokumentuara përgjatë historisë së përdorimit të asaj fjale.
5. Përkthimin e përmbajtjes së çdo fjale në një të njërit nga gjuhët evropiane, në gjuhën angleze apo franceze.

Fischeri ia kishte dalë të regjistronte trashëgiminë gjuhësore nga shkrimet e para e deri në vitin 300 hixhri (fillon më 18.08.912). Ai ndjeu mungesën e një fjalori të arabishtes të këtyre përmasave, për të përkthyer ilustrimet e cituara nga poezitë nëpër literaturë, sidomos pjesë të shkëputura nga poezia paraislame, e duke u përqendruar në poezinë e

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore periudhës emevite.

Këtë projekt Fischeri për herë të parë e bëri publik në vitin 1907, gjatë mbajtjes së Kongresit të Filologëve Gjermanë në Bazel. Projektin e tij e përsëriti edhe në Konferencën ndërkombëtare të orientalistëve, e cila u mbajt në Kopenhagen, në vitin 1908. Fischeri edhe në konferencën tjetër në Athinë, në vitin 1912, e prezantoi po të njëjtin projekt.¹⁴ Në diskutimet nëpër seancat e këtyre konferencave ai bëri me dije se karakteristikë e këtij fjalori do të ishte gjuha klasike arabe. Aty do të përfshihej gjuha e poezisë së periudhës paraislame e deri në fund të periudhës emevite, gjuha e Kuranit, gjuha e hadithit dhe gjuha e historianëve më të vjeter. Ai pohonte se do të shfrytëzonte edhe materiale leksikore të cilat i kanë lënë arabologët evropianë para tij, në rend të parë Heinrich Leberecht Fleischer dhe Heinrich Thorbecke.

Komisioni kompetent i formuar në Kopenhagen u pajtua me konstatimin në vijim: Komisioni përshëndet nisëtivën e Kongresit të pesëmbëdhjetë të orientalistëve që të përkrahë projektin e Fischerit për hartimin e fjalorit të gjuhës arabe letrare në harmoni me frymën e hartimit të fjalorëve bashkëkohorë. Unanimisht miratojmë këtë inisiativë dhe shpresojmë që të sigurohen mjete dhe materiale për realizimin e këtij projekti.¹⁵

Fischeri, projektin rreth hartimit të këtij fjalori e filloi në vitin 1914, me themelimin e Institutit për Hulumtime Saksofone në Leipzig, ku Fischeri zgjedhet drejtor i sektorit të arabistikës–islamistikës.

Fischeri, në vitin 1918, duke u bazuar në kapacitetet e tij, kishte

¹⁴ الأستاذ الدكتور محمد رشاد الجمزاي، مجلة معجمية، توني، ع. ٦-٥، ١٩٩٠، ص ١٥.

¹⁵ أ. فيشر، المرجع السابق، ص ٣٠.

menduar që këtë projekt ta përfundonte brenda tri - katër viteve, por kriza financiare që e kishte kapluar atëbotë Gjermaninë, kishte ndikuar edhe në krizën financiare të Institutit të Lajpcingut, andaj atij iu desh që projektin e tij ta vazhdonte pa ndihmën e bashkëpunorëve.

Në vitin 1936 projekti i Fischerit kishte marrë rrugë për rrumbullakësimin e tij. Në vjeshtën e atij viti Qeveria e Egjiptit, me propozimin e Akademisë së Gjuhës Arabe në Kajro, mori përsipër shpenzimet për botimin e Fjalorit historik të arabishtes dhe në të njëjtën kohë të mbulojë shpenzimet për qëndrimin e Fischerit në Kajro gjatë stinës së dimrit, me të vetmin qëllim që të përfundohej ai projekt. Kjo përkrahje nga qeveria e Egjiptit i mundësoi Fischerit që të sigurojë një numër të konsiderueshëm të bashkëpunorëve egjiptianë dhe të sigurojë mjete për blerjen e veprave të cilat i nevojiteshin.

Tani, në këto rrethana të reja të krijuara në Kajro, Fischeri thotë se i duhen rreth shtatë vjet për ta përfunduar projektin e tij. Ai ishte i vetëdijshëm për sfidat, ndaj thotë se Muḥamād Murteḏā âl-Ḥusejn âz-Zubejdîit i janë dashur katërmbydhjetë vjet për ta përfunduar fjalorin e tij *Tāxhu-l-‘arūs min-xhâvḥâri-l-kāmūs*, edhe pse pjesën më të madhe të materialit e kishte vjelë nga fjalori *Lisānu-l-‘arab*, kurse kolegut të tij Eëdëard Lanes i ishin dashur pesëdhjetë e një vjet punë për ta përfunduar fjalorin e tij. Fischeri në vazhdim përmend një varg autorësh që me decenie të tëra kishin punuar deri në botimin e fjalorëve të gjuhës arabe në gjuhën frengje dhe angleze. Ai më në fund përmend përvojen e hartimit të Fjalorit Oxford English Dictionari, ku thotë se hartimi i tij ka filluar në vitin 1884 dhe ka përfunduar në vitin 1924, duke u angazhuar në atë punë qindra ekspertë.

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore

Fischeri, në fjalorin historik të arabishtes, siç thotë edhe vetë, kishte vendosur të fillonte me mbishkrimet e gdhendura, që ishin zbuluar asokohe, e që i takonin shekullit të VI, dorëshkrimet në papiruse dhe në monedha, duke përfunduar me materialin e vjelur deri në fund të Kalifatit Omajad (v.750).

Lidhur me idenë e Fischerit për hartimin e Fjalorit historik të arabishtes ka mendime të ndryshme. Dr. Ibrahīm Mâdkūr, atëbotë sekretar i përgjithshëm i Këshillit për botimin e këtij fjalori, mendon se për ta marrë këtë nismë Fischeri ishte frymëzuar nga Fjalori i Oxfordit. Por, Prof. Dr. Muhammâd Râshshâd âl-Hamzâvī mendon se orientalisti Heinrich Thorbecke¹⁶ dhe orientalisti F. Heerdegen ishin ata që e frymëzuan Fischerin për të hartuar Fjalorin historik të arabishtes.¹⁷

Karshi kontributeve të Heinrich Leberecht Fleicherit dhe Heinrich Thorbeckes, Fischeri kishte ndërmend të përdorte edhe fjalorë që kishin botuar apo kishin lënë në dorëshkrim orientalistët, si: Dozi, Fleicher, Thorbecke, Allfedi dhe Goldziher. August Fischer punën në këtë projekt e pati filluar në vitin 1913, duke vendosur skedat me ilustrimet e shkëputura nga fjalorët dhe nga divanet.

Në këtë projekt Fischerit i kishin ndihmuar edhe Johs Pedersen, John Leëis Enoch, me prejardhje egjiptiane nga Mânfâluti, Munīr Hamândij, egjiptian nga Kajro dhe Emalia Ęodenberg. Në këtë projekt gjithashtu kanë marrë pjesë edhe Arthur Schaade dhe Erich Braunlich. Për përfundimin e këtij projekti madhor, në vitin 1932 në Egjipt u formua Asambleja e

¹⁶ Për më shumë për Heinrich Thorbecke shih, Abdurrahman Bâdâvi, op.cit. f. 153-154.

¹⁷ عبد العزيز بن حميد بن محمد الحميد، المعجم التاريخي لدى المستشرق الألماني أوجست فيشر، شبكة صوت العربية، <http://www.voiceofarabic.net/ar/articles/2355>.

arabologëve, kurse Fischeri u zgjodh anëtar i këtij komisioni. Komisioni filloi punën me grumbullimin e materialit për këtë fjalor. Fischeri për çdo dimër frekuentonte Kajron. Kjo zgjatë deri në vitin 1939. Atë vit kur shpërtheu Lufta e Dytë Botërore, Fischeri nuk pati mundësi të kthehej në Egjipt, posaçërisht pasi që në vitin 1945 u anulua anëtarësimi i tij në komisionin e themeluar në vitin 1932.

A thua cili ka qenë fati i materialit të grumbulluar që iu besua Asamblesë së arabologëve? Asamblesë, gjatë transferimit nga objekti i saj në rrugën *Kaşru-l-‘ajn* për në rrugën *Mârād* në *al-Gîzâ*, iu shkapërderdh i tërë materiali i grumbulluar i fjalorit. Nga i gjithë ai material mbeti vetëm një pjesë e vogël. Universiteti i Tubingenit dhe disa universitete të tjera gjermane u përpoqën që t’i kopjojnë ato materiale, më të vetem dëshirë që të vazhdonin punën në këtë projekt të fjalorit, për të cilin Fischeri pati punuar gjatë kohë. Mirëpo puna mbeti aty ku kishte filluar. Përkundër apeleve të shumta, askush nuk punoi për ta vazhduar këtë projekt. Kështu humbi pjesa më e madhe e materialeve që i pati grumbulluar Fischeri me ndihmësit e tij.

Në vitin 1957 u botua vëllimi i parë dhe i vetëm nga i gjithë ai material. Fjalori u titullua *âl-Mu‘xhâmu-l-lâgâvijj ât-târihijj*.¹⁸ Në këtë vëllim është përfshirë parathënia e fjalorit me 34 faqe dhe 53 faqe material të fjalëve të para që fillojnë me konsonantin e parë *hâmzâ^{në}* e deri te folja *أب* *âbâdâ*.

Fjalori i Fischerit konsiderohet ndër fjalorët më të mirë të hartuar nga ana e orientalistëve që kanë kontribuar në leksikografinë arabe. Dr. Ibrahim Medkûr për fjalorin e Fischerit thotë se është hartuar me të njëjtën

¹⁸ Sipas disa burimeve, ky fjalor është emërtuar *âl-Mu‘xhâmu ât-târihijj*.

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore metodologji sikurse *Fjalori historik i Oksofrdit*.

Se sa gjithëpërfshirës ka qenë projekti i Fischerit shihet nga paraqitja e tij në një mbledhje të grupit punues, ku kishte deklaruar se posedonte 600 skeda vetëm për kuptimin e foljes **أخذ** *âḥadhâ* me gjitha derivatet e saj. Sipas ‘Abdulaziz Bin Ḥumejd, Fischeri për materialin e vjelur për foljen **أخذ** *âḥadhâ* kishte konsultuar 292 burime.

Fischer, në parathënien e fjalorit të tij, thotë se është një numër mjaft i madh i veprave tejet të vlefshme që janë trashëguar nga e kaluara. Ai përmend një deklaratë të Xhâlâlu 'd-Dīn âs-Sujutiut (1445-1505), e botuar në vepër në tij *âl-Mâz'hir*, botim i Bulakut 1865 . V. 1. F.49, ku thotë se më duhen gjashtëdhjetë deve për t'i bartur të gjitha veprat e mia të arabistikës.¹⁹ Mirëpo Fischer mendon se kjo deklaratë e Sujutiut mbase edhe ishte ekzagjeruar. Ai këtë e mbështet pikërisht në një prononcim të vetë Sujutiuku, ku thotë se veprat e hartuara nga pararendësit nuk janë më shumë se një barrë e një deveje.

Karshi veprave në gjuhën arabe në fusha të ndryshme të cilat i kishte konsultuar, Fischer sjell titujt e njëzetë e dy fjalorëve, ashtu siç i kishte renditur Edward Lane në parathënien e fjalorit të tij *Arabisht-anglisht*, duke filluar me fjalorin e parë të gjuhës arabe *Kitābu-l-ʿajni* të autorit Ḥalīl Bin Ahmād Bin Amr Bin Tāmīm (vdiq më 717-786) e deri te fjalori *âl-Mutâḥaṣiṣ*, me autor Ibn Sīdâh, i cili konsiderohet ndër fjalorët më shterues në historinë e leksikografisë arabe.

Në parathënie të fjalorit të tij, Fischeri thotë se ka mjaft shprehje që hasen në fjalorët e hartuar nga autorët arabë e që ai nuk ia ka dalë t'i hasë

¹⁹ أ. فيشر، المرجع السابق، ص 3.

në asnjë vepër që kishte hulumtuar. Kjo, sipas Fischerit, lë mundësinë të konstatojmë se autorët e fjalorëve para tij kanë disponuar materiale gjuhësore të vjelura nga veprat të cilat nuk ia kanë dalë t'i mbejtojnë kohës, e të cilat sot nuk kemi mundësi t'i konsultojmë. Fischeri, deri diku, shpreh një dozë dyshimi në sakëtsinë e kuptimit të këtyrte fjalëve. Ai këtë e argumenton edhe me faktin se autorët arabë, në të shumtën e rasteve, kishin vjelur material nga divanet (përmbledhjet) e poezisë klasike dhe veprat letrare të gjeneratave të mëpasme, kryesisht të botuara në Egjipt dhe në Hajdarabad,²⁰ e që sipas tij duhet patur kujdes se ky leksik nuk prezantonte mbarë leksikun e gjuhës arabe.

Fischeri, duke qenë njohës i shkëlqyer i gjuhëve semite dhe josemite me të cilat ka qenë arabishtja në kontakt të vazhdueshëm, vëren se një korpus jo i paktë në fjalorët paraprakë janë konsideruar fjalë me prejardhje arabe. Ai sjell disa fjalë të cilat në fjalorët paraprakë janë konsideruar si fjalë arabe me rrënjë trekonsonante, e që në fakt janë huazime. Fischeri më tej thotë se autorët e deritanishëm në fjalorët e tyre kanë përfshirë vetëm leksikun e gjuhës letrare, kurse tani duhet menduar për hartimin e një fjalori bashkëkohor historik të arabishtes. Në këtë fjalor historik, thotë ai, duhet të përfshihet i gjithë leksiku i arabishtes, duke prezantuar zhvillimin e çdo fjale përgjatë periudhave historike nëpër fjalorët paraprakë.

Fjalori i Fischerit konsiderohet ndër fjalorët më të mirë të hartuar nga ana e orientalistëve që kanë kontribuar në leksikografinë arabe.²¹

²⁰ أ. فيشر، المرجع السابق، ص ٢٦.

²¹ عبد العزيز بن حميد بن محمد الحميد، المعجم التاريخي لدى المستشرق الألماني أوجست فيشر، شبكة صوت العربية، <http://www.voiceofarabic.net/ar/articles/2355>

Fischeri që në fillim thotë se leksikun e fjalorit të tij e kishte vjelur edhe nga fjalorët e kolegëve të tij orinetalistë. Ai ndër fjalorët më të mirë të hartuar nga perëndimorët përmend fjalorin *Supplement*" të Reinhart Dozysë,²² fjalorin *Latinisht- arabishti* të Goliusit,²³ fjalorin tjetër *Arabisht- latinisht* të orientalistit gjerman Freytag.²⁴

Mirëpo hartuesit e Fjalorit historik të arabishtes të Dohas janë të mendimit se Fjalori i Fischerit nuk i plotëson të gjitha kushtet për t'u quajtur *fjalor historik*. Ata ndër arësyet kryesore cekin se Fischeri u mjaftua vetëm me materialin e vjelur në literaturën letërore dhe se u kufizua në zona të caktuara.²⁵ Sipas tyre, fjalori historik duhet të përfshijë leksikun nga të gjitha fushat, si nga fusha e letërsisë, shkencës dhe artit dhe se leksiku të vilet gjithandej ku është shtrirë gjuha arabe. Sipas tyre, arsyja kryesore se pse ky fjalor nuk mund të quhet fjalor historik, është se Fischeri është ndalur në fund të shekullit të tretë hixhri. Ata janë të mendimit se fjalori historik duhet të përfshijë leksikun më të vjetër të regjistruar të një gjuhe dhe të prezantojë zhvillimin e atij leksiku deri në periudhën e botimit të fjalorit, kurse fjalori i Fischerit përfshin vetëm leksikun e një periudhe të caktuar.²⁶

Një orientalist tjetër që i ishte rrekur hartimit të një fjalori të

²² Për më shumë për Reinhart Dozysë dhe fjalorin e tij, shih: Abdurrahman Bâdâvî, op.cit. f.316-321.

²³ Për më shumë, shih: Abdurrahman Bâdâvî, op. cit. f. 219 -222.

²⁴ Për më shumë, shih: Abdurrahman Bâdâvî, op. cit. f. 329.

²⁵ Rreth përkufizimit gjeografik të përdorimit të një shprehjeje të caktuar, Fischeri në parathënien e tij mangësi kryesore të fjalorëve paraprakë sheh se shumica e autorëve para tij janë bazuar vetëm në tekstet që janë vjelur në Egjipt. Ai mëton të ketë përfshirë edhe autorë të Gadishullit arabik. August Fischer, op. cit. f.26.

²⁶<https://www.google.com/search?q=%29%2F%23%2Fhttps%3A%2F%2Fëë.dohadicti onary.org%28>.

arabishtes mjaft voluminoz është edhe Edward Lane. Fjalori i Edward Lanes titullohet *Arabice – English Lexicon (Meddu-l-kāmūs)*. Fjalori i Lanes, siç shihet edhe nga vetë fjala e botuesit, përfshinë gjitha foljet dhe derivatat e tyre dhe mënyrat e përdorimit të tyre. Fjalori i Lanes është përfshirë në tetë vëllime. Për hartimin e këtij fjalori, autorit i janë dashur tridhjetë e pesë vite punë.²⁷

Orientalisti Dr. G. P. Badger thotë se Fjalori i Lanes është një vepër e mrekullueshme, gjithëpërfshirëse, është i saktë dhe me një rënditje të thjeshtë të fjalëve. Ai më tej shton se ky fjalorë është ndër fjalorët më të mirë në cilën do gjuhë të botës.²⁸

Vëllimi i parë i fjalorit të E.Lanes është botuar në vitin 1863, kurse vëllimi i fundit, derisa ai ishte gjallë, është botuar në vitin 1876. Vëllimi i fundit, i teti me radhë, është botuar nën përkujdesin e nipit të tij Stanley Lane Poole, në vitin 1893.

E. Lane gjatë hartimit të fjalorit të tij, mbështetje kryesore ka pasur fjalorin Lisānu-l-’arab, por pa lënë anash edhe fjalorët *Tāxhul-l-’arūs* dhe *Kāmūsul-muḥīṭ*.²⁹

Pas projektit të Fischerit, kemi iniciativën e Abdulla âl-’Alājī (1914-1996) në Liban. âl-’Alājī ishte një studies i pasionuar i gjuhës arabe deri në atë masë sa që është quajtur edhe *Yll i gjuhës arabe*. âl-’Alājī konsiderohet një ndër studiuesit më të spikatur të reformimit të arabistikës.³⁰ Ai ia kishte dalë të vjelë një leksik të arabishtes, deri atëherë i pashembullt. Ishte tejet i

²⁷ Abdurrahman Bâdâvī, op. cit. f. 86.

²⁸ Për më shumë shih: Abdurrahman Bâdâvī, op. cit. f. 83-87.

²⁹ Për më shumë shih: Abdurrahman Bâdâvī, op. cit. f. 83-87.

³⁰ الدكتور أيوب أبو دية، موسوعة أعلام الفكر العربي الحديث والمعاصر. طبعة ثالثة، ٢٠١٨، المملكة الأردنية الهاشمية، ص٤٠٧-٤١٢.

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore bindur se kishte arritur në atë fazë që të hartojë një fjalor të veçantë në krahasim me pararendësit. Botoi katër pjesët e para në vëllimin e parë, të cilin e kishte titulluar: *âl-Mârxhi‘, mu‘xhâm vâsīt, ‘ilmij, lâgâvij, fânij, bi-hâsâbi lâfđihi*. Vëllimi i parë është botuar në vitin 1963, para luftës qytetare në Liban. Lufta qytetare në Liban rrezikoi vazhdimin e botimit të këtij fjalori. Gjatë kësaj lufte qytetare, një dorë e shëmtuar shkatërroi me mijëra skeda. Ishte planifikuar që i tërë ky fjalor të botohej në njëzetë e katër vëllime. Secili vëllim përbëhej nga njëzetë e katër pjesë. Megjithëqë ishin të përgatitur 576 kapituj, u botuan vetëm katër prej tyre. *âl-‘Alājli* kishte përgatitur një fjalor enciklopedik gjithëpërfshirës, me shpresë të hapte rrugë për një etapë të re në hartimin e një fjalori të përmamasave enciklopedike.³¹

Adulla *âl-‘Alājli* fjalorin e tij e kishte ndarë nëpër epoka. Epokën nga viti 742 deri në vitin 1515 e kishte ndarë në gjashtë periudha: Periudha e ndikimit të persianëve, turqve, bevahive, selxhukëve, mongolëve dhe memalikëve.

Pas këtij projekti të dështuar kemi një projekt tjetër të ashtuquajtur *âl-mu‘xhâm at-tarīhij âl-‘arabij* (MTA). Ky projekt ishte projekt i Fakultetit të Letërsisë, Qendrës për studime ekonomike dhe sociale dhe Shoqatës së leksikologëve arabë të Tunisit. Këto insitucione takimin e parë e mbajtën në vitin 1989, duke marrë vendimin se fillimi për hartimin e një fjalori historik të arabishtes ishte domosdoshmëri e kohës dhe se një fjalor historik i arabishtes do të prezantonte kujtesën gjuhësore dhe kulturore dhe civilizuese të popullit arab. Ekipi realizues i këtij fjalori udhëhiqej nga Dr. Râshād al-Ḥamzāvī. Ekipi ia kishte dalë të grumbullonte dëshmi nga krijimtaria poetike e nëntëdhjetë poetëve të periudhës paraislame, duke

³¹ سليمان بن صالح الخراشي، نظرة شرعية في فكر: عبدالله العلايلي، نظرات شرعية، (المجموعة السابعة)، ص ١١.

përfshirë periudhën nga viti 200 deri në vitin 600. Ata kishin hartuar 58.023 skeda. Projekti dështoi për shkaqe financiare dhe nuk e pa dritën e botimit.³²

Këto nisiativa të vazhdueshme për të pasur një fjalor historik të arabishtes u kurorëzuan më në fund më 2012, kur Qendra arabe për hulumtime dhe studime të avancuara me seli në Doha u zotua për ta përgatitur Fjalorin historik të gjuhës arabe. Përfundimi me sukses i fazës së parë të *Fjalorit historik të arabishtes i Dohas* (tani e tutje FHAD) u bë publik më datën 10.12.2018. Me këtë rast u mbajt konferenca shkencore me titullin *Fjalorët historikë të gjuhëve, krahasimet dhe qasjet*. Në këtë konferencë u prezantuan kumtesa rreth fjalorëve historikë të gjuhëve botërore, si Fjalori historik i gjuhës angleze, gjermane dhe frënge.

Dr. ‘Azmi Bâsharâ, drejtor i Institutit të Dohas për studime të avancuara, në fjalën e tij me rastin e promovimit të këtij projekti, ndër të tjera theksoi se "ideja për hartimin e këtij fjalori nuk është e jona, por ne realizuam një projekt që ka qenë ëndërr e kahmotshme e mbarë opinionit akademik për të pasur një fjalor historik të gjuhës arabe."³³ Ky projekt, sipas tij, është realizuar falë punës kolektive të ekipit. Të gjithë ne kemi qenë të vetëdijshëm se na pret një rrugëtim i gjatë dhe me plot vështirësi, por në të njëjtën kohë kemi qenë të vendosur dhe këmbëngulës dhe, falë përkrahjes institucionale nga udhëheqësia e shtetit të Katarit, ia kemi dalë të realizojmë këtë projekt. Ai, më tej, me këtë rast shtoi se për një periudhë pesëvjeçare, duke u kordinuar të gjithë sektorët e ekipit, ia kemi dalë që të

³² <https://www.dohadictionary.org/#/about-dictionary>

معجم الدوحة-التاريخي-اللغة-العربية-الهدية-التمينة – للأمة. <https://www.alaraby.co.uk/opinion/2018/12/13/> ³³

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore kemi Fjalorin historik të gjuhës arabe, një e arritur në nivel jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar.

Sipas Dr. 'Azmiut, etapa e parë e hulumtimit të materies përfshin periudhën 700 vjeçare të historikut të gjuhës arabe. Kjo etapë fillon me shkrimet e para të gdhendura në gurë e deri në fund të shekullit të dytë hixhri. Faza e parë për realizimin e këtij projekti filloi në muajin maj të vitit 2013, kur u bë publike fillimi i fazës së parë e deri në bërjen publike të përfundimit të fazës së parë, në dhjetor të vitit 2018. Në këtë platformë janë regjistruar 100 000 fjalë.

Etapa e dytë do të përfshijë periudhën nga vitit 817 e deri në vitin 1117, kurse etapa e tretë përfshin periudhën deri në ditët tona.

Në vitin 2012 u ftuan ekspertë nga fusha e gjuhësisë si Râmzi Ba'lâbâk, Muhammâd âl-'Abîdî, Izu 'd-Dîn âl-Bushâjhî etj. Në krye të ekipeve të zgjedhura Râmzi Ba'lâbâk, i cili me sukses ia doli të realizojë projektin për hartimin e FHAD.

Në këto takime u kërkua që të krijohet një ekip nga studiuesit e fushave përkatëse. U punua pa ndërprerë në atë drejtim dhe kur ekipi u kompletua, më 25.5.2013, u bë publike përbërja e tij. Ishte një ekip tejet serioz dhe profesional. Në këtë fazë u ngazhuan 300 leksikologë, studiues, ekspertë të informatikës dhe administratorë të projektit.

Synimi i kësaj nismie ka qenë finalizimi i FHAD, duke regjistruar korpusin gjuhësor gjithëpërfshirës të gjuhës arabe.³⁴

Ekipi realizues i FHAD kishte hartuar planin e realizimit në këto faza:

1. Faza e grumbullimit dhe klasifikimit të materialit.

³⁴ <https://www.dohadictionary.org/#/about-dictionary>.

Burimet e fazës së parë janë të kufizuara deri në fund të shekullit të dytë hixhri, duke përfshirë 772 tituj në fusha të ndryshme, si:

a. Leksiku i teksteve fetare, i cili përfshin 144 tituj në tri fusha:

1. Fusha e shencave të Kuranit, duke përfshirë 55 tituj;
2. Fusha e hadithit, e cila përfshin 48 tituj;
3. Fusha e shkencës së Fikhut dhe Akaidit, me 41 tituj.

b. Leksiku i teksteve letrare, i cili përfshin 500 tituj në katër fusha:

1. Divane të zgjedhur nga poezia klasike (paraislame), me 153 tituj;
2. Divane të zgjedhur nga poezia paraislame dhe islame, e periudhës emevite, fazës së parë të periudhës abasite e deri në fund të shekullit të dytë hixhri. Kjo fushë përfshin 252 tituj.
3. Divane të grupeve të autorëve dhe poezi të përzgjedhura, me 65 tituj;
4. Tekste të prozës artistike, 30 tituj.

c. Leksiku i teksteve historike, tekste të marsheve dhe të shkencave të tjera, i përfshirë në 82 tituj në dy fusha:

- Tekste të vjetra të gdhendura, 70 tituj;
- Tekste në papiruse të periudhës islame, 12 tituj.

2. Faza e redaktimit të materialit.

Pas grumbullimit të materialit, ekipi i ekspertëve të fushave ka bërë eliminimin e fjalëve të përsëritura. Është konsideruar i pranueshëm vetëm ai version i një fjale të caktuar që ka qenë e vjelur nga dokumentet më të besueshme. Gjithashtu janë eliminuar zërat e vjelur nga tekstet që nuk kanë qenë të periudhës gjegjëse. Ekspertët e hartimit të këtij fjalori historik kanë qenë tejet rigorozë karshi titujve të dyshimt dhe, në fund, zërat janë rënditur sipas vjetërsisë.

Mbishkrimet arabe të gdhendura

Ekipi realizues i FHAD, me qëllim të krijimit të një kodi gjuhësor gjithëpërfshirës, nuk ka lënë anash as edhe një tekst bazik. Ata kanë konsideruar se mbishkrimet janë shtylla kryesore e fjalorit historik në të cilin duhet mbështetur. Mbishkrimet gjithashtu janë konsideruar burimi kryesor që ushqen leksikon e gjuhës arabe duke ofruar informacione të mjaftueshme për historikun e një fjale të caktuar. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre mbishkrimeve të gdhendura, sipas autorëve të FHAD, nuk janë përfshirë në fjalorët paraprakë të gjuhës arabe. Mbishkrimet e përfshira në këtë fjalor historik janë të dy kategoria kryesore: mbishkrimet veriore të lashta arabe dhe mbishkrimet e vjetra arabe.³⁵

FHAD, sipas relizuesve të këtij projekti, mëton të jetë unikat, nuk do t'i ngjajë asnjë fjalori të arabishtes i hartuar deri sot. E veçantë e këtij fjalori është se ofron informata se kur për herë të parë është përdorur një fjalë e caktuar, si dhe paraqet raportin e saj me gjuhët e tjera të së njëjtës familje. Ajo që e bënë të veçantë këtë fjalor janë edhe informatat e huazimeve, duke ofruar të dhëna rreth origjinës së huazimeve qofshin ato huazime perse apo greke. Ky fjalor shpjegon edhe termat e fushave të ndryshme. Karakteristikë e veçantë e këtij fjalori është se për çdo fjalë ofron të dhëna se çfarë kategorie gramatikore i takon ajo fjalë, duke saktësuar se është emër, emër i prejardhur qoftë ai masdar, apo ndonjë formë tjetër e emrave të prejardhur, mbiemër, folje, qofshin ato folje kalimtare apo jokalimtare etj.

Duke marrë parasysh leksikon e trashëguar përgjatë këtyre shekujve, materiali i prezantuar në këtë fjalor do të ndihmojë edhe në ndriçimin e

³⁵ <https://www.dohadictionary.org/#/about-dictionary>

shumë enigmave edhe te gjuhët e tjera të gjalla që në një mënyrë apo tjetër kanë qenë në kontakt me gjuhën arabe.

Janë konsultuar 1.256 dokumente, poezi, përmbledhje poezishë, antologji të poezisë arabe të njohura, si *Kutub-l-ḥamāsa*, divane, tregime, etj.³⁶

Nga burimet e prozës janë konsultuar mëse 567 dokumente. Këtu janë përfshirë të gjitha burimet, mbështetur në dokumente nga veprat e ndryshme të prozës arabe.

Burim i pakapërcyeshëm në këto raste është leksiku i Kuranit dhe nëntë koleksionet e njohura të Hadithit.

Dhe në fund, janë përfshirë 89 burime ku janë përfshirë vepra të shkruara deri në shekullin e dytë hixhri (shek.VIII). Këto vepra iu përkasin fushave të ndryshme, si asaj të prozës letrare, Hadithit, Tefsirit, vepra të filologëve, letrarëve etj.

Hartimi i FHAD është një projekt unik në historinë e leksikologjisë arabe. Idetë e zhvillimit gjuhësor tek arabët kanë kaluar nëpër shumë pengesa, sidomos në Egjipt dhe në Siri. Koncepti i elokuencës ishte një nga pengesat e atij zhvillimi, sepse konsiderohej se duhet t'i rezistohej çdo ndryshimi në gjuhë. Megjithatë, FHAD na mundëson të njohim kulturën arabe dhe cilësinë e përceptimit të botës që e rrethon atë. Ky fjalor na mundëson të dimë se si janë përdorur fjalë të caktura për të shprehur mendimet, emocionet dhe nevojat e tyre brenda një kohe të caktuar. Gjithashtu, na ofron infomata të rëndësishme për qytetërimin arab, siç janë ushqimi, pijet, verërat, veshjet, armët dhe arkitektura. Nëpërmjet këtij fjalori

³⁶ <https://www.dohadictionary.org/#/about-dictionary>

—— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore historik njihemi me evolucionin e kuptimit të fjalëve përgjatë shekujve.

Gjatë hartimit të FHAD, karshi trashëgimisë, janë konsultuar edhe fjalorë modernë të termave nga shkencat e mjekësisë, astronomisë, fizikës, gjeografisë, matematikës, filozofisë dhe shkencave të tjera.

Në leksikografinë arabe, siç u cek edhe më lart, tradita e renditjes së fjalëve në fjalor, pavarësisht renditjes së konsonanteve, ka qenë një renditje e larmishme, varësisht nga ajo se cila shkollë e leksikografisë arabe është aplikuar apo nga ajo që ka qenë unike të gjitha shkollat e leksikografisë arabe, që fjalët janë renditur sipas konsonantit të parë të rrënjës së fjalës.

Mirëpo, hartuesit e FHAD nuk kanë ndjekur asnjërin nga këto tradita, duke cekur arsyet e tyre. Ata janë përcaktuar të ndjekin një metodë tjetër. Bazuar në të dhënat që ofrohen në parathënie të FHAD dhe në platformën elektronike të FHAD, shihet se ata kanë ndjekur një sistem tjetër. Rënditja e fjalëve në fjalor është bërë duke u bazuar në historinë e paraqitjes së fjalës në mbishkrime, në tekste apo kudo që është paraqitur një fjalë e caktuar. Ata janë të mendimit se ka qenë e pamundur që gjatë hartimit të këtij fjalori të ndjekin metodat e lartpërmendura. Sipas tyre, hulumtuesi vetëm në këtë mënyrë do të marrë informata për një fjalë se kur dhe ku është përdorur për herë të parë. Gjithashtu, ndodh që një fjalë të jetë përdorur në disa burime, dhe nuk do të dihej se në cilin burim është përdorur për herë të parë. Andaj ekipi i hartimit të FHAD, pas shumë konsultimeve, për shkak të natyrës së veçantë të këtij fjalori, u përqendrua që të ndjekë renditjen e fjalëve sipas një metodologjie të veçantë, deri tani e paparë në historinë e leksikografisë arabe. Për çdo fjalë është dhënë pasqyra kohore se kur është përdorur për herë të parë, cili është burimi dhe cili ka qenë kuptimi i saj në atë burim, duke vazhduar me kuptimet e tjera nëpër burime të tjera, aty ku është përdorur ajo

fjalë përgjatë historisë, që nga përdorimi i parë e deri në fund të shekullit të dytë hixhri.

Kjo renditje e bën të veçantë këtë fjalor dhe i jep kuptim emërtimit të FHAD *Fjalor historik i gjuhës arabe*.

Kuptimi i një fjale të caktuar është ngusht i lidhur me historikun e përdorimit të saj që nga shfaqja në tekste të dokumentuara përgjatë historisë.


Qasja në platformën e FHAD është mjaft praktike dhe e lehtë. E gjitha që duhet bërë është që fillimisht duhet regjistruar në platformën e FHAD-it, e pastaj në dritaren ku janë të prezantuara të gjitha rrënjët kërkohet të shënohen bashkëtingëlloret rrënjësore të fjalës, kurse në dritaren tjetër të shkruhet fjala në formë të plotë. Posa të përfundohet me këto të dhëna, duhet të klikohet në ikonën *baħthçërkim*] dhe në ekran do të paraqitet e gjithë pasqyra e fjalës.

Me këtë rast, për të dëshmuar gjithë atë që u tha deri tani rreth informatave për një fjalë të caktuar, po sjellim një ilustrim rreth kuptimit dhe historikut të fjalës *kitāb* në FHAD:

- Në vitin 380, në poezinë e poetit Lākīṭ Jā'mur Bin Ḥārixhātu āl-'Ijādī, me kuptimin *letër e shkruar*;
- Në vitin 594, në poezinë e poetes Dāħtūs Bint Lākīṭ, me kuptimin *vdekje*;
- Në vitin 573, në poezinë e poetes āl-Ḥīrnīk Bint Bādr āl-Bāqrijetu, me kuptimin *paracaktim*;
- Në vitin 617, në Kuran (69:19), me kuptimin *regjistër*;
- Në vitin 619 në poezinë e poetit 'Ābū ṭālib, me kuptimin *libër i shenjtë*;

— Fjalori historik i arabishtes i Dohas: Kurorëzim i përpjekjeve njëshekullore

- Në vitin 625, në Kuran (98:3), me kuptimin *dispozitë*.³⁷




Platforma elektronike e FHAD është mjaft e pasur me të dhëna për historinë e gjuhës së shkruar arabe nëpër periudha të caktuara. Grafikonet në vijim na japin një pasqyrë mjaft të qartë për historikun e gjuhës arabe të shkruar.

Grafikoni nr. 1 ofron të dhëna për numrin e burimeve të gjuhës arabe të shkruar përgjatë periudhës kohore, duke filluar nga burimet e para e deri në vitin 200 hixhri,³⁸ kurse grafikoni nr. 2 na ofron një pasqyrë të qartë për avancimin e gjuhës arabe të shkruar përgjatë të njëjtës periudhë historike. Sipas grafikoni nr.2, shihet qartë se trajektorja e historisë së shkrimit të gjuhës arabe përgjatë periudhave të caktuara ka pësuar rënie. Sipas këtij grafikoni, shihet se përgjatë periudhës së shtetit Emevit kemi një rënie rapide, kurse me ardhjen e abasitëve në pushtet, grafikoni ka ngritje të dukshme.

³⁷ <https://www.dohadictionary.org/#/dictionary/%D9%83%D8%AA%D8%A7%D8%A8>

³⁸ <https://www.dohadictionary.org/#/charts>



Fjalori FHAD ofron të dhëna edhe për huazimet nga gjuhët përreth saj apo, siç janë quajtur, shprehje të rrënjosura në gjuhën arabe. Nëpërmjet këtij projekti, ekspertët kanë ofruar të dhëna rreth zhvillimit të gjuhës arabe përgjatë gjithë kësaj periudhe.

FHAD pa dyshim do të kristalizojë identitetin arab të banorëve të këtyre vendeve, duke e konsideruar si identitet universal dhe të jashtëzakonshëm karshi identitetit stërgjyshor dhe ideologjik, siç janë identitetet sektare, etnike, fisnore dhe rajonale.

Autorët e realizimit të FHAD pretendojnë se ky fjalor mundëson një rilindje gjithëpërfshirëse gjuhësore edhe në leksikografi, dhe me këtë krijon kushte për të avancuar punën në hartimin e fjalorëve terminologjikë të shkencave të ndryshme. Ky fjalor mundëson edhe rileximin e teksteve të vjetra nga kultura arabe.

Materialet në Fjalorin historik të arabishtes janë të botuara në platformë elektronike që ofron shërbime rreth leksikut, bibliografisë, kontekstualizimit, teksteve, burimet tekstuale dhe udhëzues për përdorimin e fjalorit.

FHAD, pavarësisht përpjekjeve të hartuesve për të qenë gjithëpërfshirës, ai megjithatë duhej të kufizohej për shkak të arsyeve objektive që vështirë tejkaloheshin. Përballë leksikut voluminoz të arabishtes, ishte vështirë të pretendohesh se edhe në këtë fjalor do të përfshihej e gjithë trashëgimia gjuhësore, marrë parasysh se një pjesë mjaft e madhe e teksteve ende janë në dorëshkrim dhe pa ndonjë studim kritik.

Edhe realizuesit e këtij fjalori historik të arabishtes nuk pretendojnë se kanë përfshirë gjithë leksikun e gjuhës arabe, ndërtimet, si dhe kuptimin e fjalëve që nga fillimi e deri në ditët tona. Duke marrë parasysh shtrirjen gjeografike të arabishtes, autorët e FHAD janë të vetëdijshëm se mund të ketë edhe tekste të periudhës deri në shekullin e dytë hixhri, e që këta nuk ia kanë dalë të arrijnë deri tek ato. Ka edhe mjaft mbishkrime të gdhendura që janë zhdukur e që kanë mbetur pa u përfshirë në këtë fjalor. Fjalori do të jetë i hapur për t'u plotësuar me fjalë të reja, apo fjalëve të regjistruara t'u shtohen kuptime që kanë pasur ato përgjatë historisë.

Për të prezantuar gjithë vlerat e FHAD, edhe sikur të shkruhej edhe një monografi e tërë, nuk është e mjaftueshme, por ne me këtë rast do të mjaftohemi me kaq, me shpresë që në të ardhme ky projekt aq i vlefshëm për arabistikën do të jetë në epiqendër të interesimit të arabistëve.

Publicistika arabe, me rastin e lansimit të kësaj paltfome, FHAD e ka quajtur anije për të lundruar në detin e historisë së gjuhës arabe (âl-²Arabij âl-xhedîd, 13.12.2018). Kushdo që dëshiron të ketë informata për kuptimin e një fjale përgjatë një periudhe të caktuar, atë mund ta gjejë në FHAD.

Sipas përshtypjes së gjithë atyre të cilët kanë pasur rastin të njihen me këtë platformë në të cilën është përfshirë FHAD, del se tani ky fjalor historik i arabishtes së shkruar i ngjan pemës e cila rrënjët i ka në Doha, kurse degët gjithandej ku flietet arabishtja dhe gjithandej ku ka të interesuar për studimin e gjuhës arabe.

Le të shpresojmë që ky projekt madhor të përfundojë sipas planit të hartuar dhe, brenda kohës së paraparë, edhe arabishtja të ketë fjalorin e vet historik të plotë.

Doha's Historical Arabic Dictionary:

A twist of one-century efforts

Abstract *

The lexicography among the Arabs has a very early and sensational tradition. Despite the fact that the first Arabic dictionary had been compiled in the VIII century by Ḥalīl Bin Ahmad Bin al-Fārāhīdij, we had to wait for the XXI century to have the Historical Arabic Dictionary.

The initiative for compiling of the historical dictionary of the Arabic language was even earlier. One of the most serious initiatives for compiling a dictionary of this magnitude is that of the Arabic Language Academy in Cairo in 1932. Another initiative for the compilation of the historical dictionary of Arabic was that of the German Orientalist August Fischer in 1913. After this initiative we have the initiative of Abdulla 'ala-'Alājīlī in Lebanon. Another project for the compilation of the historical dictionary of the Arabic language was also the project of the Association of the Arabic Language Academy and Sciences in Tunisia.

All these efforts were not fulfilled, and did not result in any concrete results for having the full Historical Arabic Dictionary. From Fischer's Dictionary, only the first volume was published in 1967 in Cairo and that of Abdulla al-'Alājīlīt with only one volume published in 1963.

The project for the Historical Arabic Dictionary, the long-awaited project, was launched on May 25, 2013 by the Arabic Research Centre in Doha with a team led by Râmzi Ba'lâbak, and the completion of the first stage, out of three, was promoted in December 2018.

* Professor of Arabic Language at the Department of Oriental Studies, Faculty of Philology, University of Prishtina "Hasan Prishtina", author of the Arabic - Albanian Dictionary (2011).

LOGJIKA E ARISTOTELIT NË MEDRESETË SHQIPTARE**Abdulla Rexhepi *****Abstrakt**

Filozofët myslimanë, si shumë dije dhe shkenca të tjera, edhe Logjikën e huazuan nga grekët e lashtë, sidomos nga Aristoteli. Filozofi më i njohur grek në botën islame konsiderohet Aristoteli, veprat e të cilit u përkthyen në gjuhën arabe dhe trashëgimia e tij filozofike pati ndikimin më të madh në kulturën e mendimit mysliman. Në shekullin e III-të, Prophyrius Tyrius, pjesës së parë të Organonit, pra pjesës së Kategorias ia shkroi një hyrje me titull “Esagoge” (në kuptimin e Hyrjes), e cila që nga ajo kohë është cilësuar si çelës i zbërthimit të kuptimeve të veprave të Aristotelit në fushën e Logjikës. Që nga ajo kohë, kjo vepër është bërë pjesë e pandashme e përmbledhjes së veprave të logjikës së Aristotelit. Si gjithë veprat e tjera, edhe kjo është përkthyer në gjuhën arabe dhe është komentuar nga shumë logjicienë myslimanë. Madje, shumë prej tyre dhe shkruan ‘Isaguxhi, pra hyrje në fushën e Logjikës, ku më e njohura prej këtyre veprave është ajo ‘Âthîru-d-Dîn âl-Âbhârij -ut (v.1276), vepra e të cilit njihet me emrin “*Isaguxhi*” apo “âr-Risâlâ - âl-âthârijjâ *ft-l-Mânîk*”. Ajo ka qenë njëra ndër veprat kryesore të dijes së Logjikës nëpër medresetë e botës islame, duke përfshirë edhe medresetë e shqiptarëve. Kjo vepër, bashkë me disa vepra të tjera nga fusha e Logjikës kanë qenë pjesë të programeve mësimore nëpër medresetë shqiptare, të cilat kanë ekzistuar deri kah fundi i shekullit të kaluar. Në këtë punim, në fillim do të prezantoj dhe analizoj veprën ‘Isaguxhi të ‘Abhariut, dhe më pastaj do të përpiqem të trajtoj mësimin e kësaj vepre në medresetë shqiptare, duke u fokusuar në medresenë e hafiz Nexhatisë në Preshevë. Metodologjia e ndjekur në këtë punim është prezentative-analitike në pjesën e parë, dhe studim në terren, në pjesën e dytë.

Fjalë Kyçe: Logjika, Aristoteli, ‘Isaguxhi, ‘Abhari, medresetë shqiptare.

* Prof. Ass. Dr. i Gjuhës dhe Letërsisë perse dhe Gjuhës Osmane në Departamentin e Orientalistikës - Universiteti "Hasan Prishtina", Prishtinë.

Hyrje

Logjika është definuar si shkencë që mëton studimin e formave dhe ligjeve të të menduarit të drejtë¹. Logjika merret edhe me nocionet, gjykimet (premisat) dhe konkludimet e individit. Nga shumë dijetarë, ajo është cilësuar edhe si “çelësi i të gjitha dijeve” apo “bazë e secilës shkencë”. Megjithëse edhe para tij pati veprimtari intelektuale, Aristoteli² (384 - 322 p.e.s.) llogaritet themelues i Logjikës si disiplinë më vete. Duhet theksuar se mendimtarët grekë para-sokratikë kanë përdorur forma dhe premisa logjike në hulumtimet e tyre natyrore dhe humane-shoqërore. Veprat e pjesëtarëve të shkollës Elea dhe të sofistëve në Greqinë e lashtë, vlerësohen si parapërgatitje e themelimit të Logjikës. Kështu, Aristoteli si trashëgimtar i kësaj dijeje filozofike, me qëllim të sistemimit të të menduarit në një disiplinë më vete dhe të parandalimit të mendimit të gabuar te individët, vendosi rregulla të caktuara. Prandaj, në historinë e mendimit njerëzor ai që i pari që krijoi nocionet dhe premisat e gjykimit të drejtë. Në fakt, për Aristotelin Logjika nuk është shkencë, por është një mjet apo dije që duhet mësuar para se të merremi me ndonjë shkencë tjetër, pra është një mjet³ për

¹ Mbi definacionet për Logjikën, shih: Peter Smith. *An Introduction to Formal Logic*. Cambridge University Press, (6th printing) 2013. Patrick J. Hurley. *A Concise Introduction to Logic*. (versioni elektronik).

² Aristoteli lindi në Stragira, të Trakisë në Greqinë e lashtë, dhe u shkollua në Akademinë e Platonit. Njihet si njëri ndër filozofët më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Ai është autor i shumë veprave, të cilat pas vdekjes së tij i përgatitën nxënësit e tij - mbi Filozofinë, Logjikën, Teologjinë, Moralin, Poezinë, Politikën, etj.. Për më tepër, shih: Ferguson, John (1972). *Aristotle*. Neë York: Tayne Publishers. Ackrill, J. L. (1981). *Aristotle the Philosopher*. Oxford and New York: Oxford University Press.

³ Platonistët e lashtë mendonin se Logjika është edhe pjesë e filozofisë por edhe mjet i saj, ndërsa peripatetikët mbronin qëndrimin se ajo është vetëm mjet i filozofisë. Në anën tjetër, Stoikët mbronin qëndrimin se Logjika është vetëm një pjesë e filozofisë. Edhe logjicienët myslimanë i kishte preokupuar çështja nëse Logjika është pjesë e filozofisë apo vetëm një mjet i saj. Në tekstet klasike të logjicienëve myslimanë i hasim të dy qëndrimet,

mësimin e shkencave të tjera. Logjika e Aristotelit ka qenë logjikë formale, prandaj ai, në sistemimin që ua bëri dijeve, Logjikën nuk e rradhiti në asnjërin grup prej tyre. Meqë për Aristotelin Logjika është vetëm mjet apo formë e shkencës, ajo zë vend në hyrje të dijeve dhe shkencave dhe kjo është arsyeja pse shkrimet dhe përsiatjet e tij mbi Logjikën i përmbledhën në veprën të cilën e quajtën Organon, në kuptimin e mjetit/instrumentit. Vepra Organon në fillim përbëhej nga shtatë pjesë: Kategoritë (lat. Categoriae), Interpretimet (lat. Peri hermeneias), Analitika e Parë (lat. Analytika protera), Analitika e Dytë (lat. Analytika Hystera), Topika/ Polemika (lat. Topika) dhe Argumentet sofistike (lat. De Sophisticis Elenchis). Më pas, logjicienët kësaj vepre ia shtuan edhe dy vepra të tjera të Aristotelit, Retorika (lat. Rhetorica) dhe Poetika (Peri Poietikes), si dhe veprën Eisaguge (Eisagōgē) të Porporiusit (Porphyry). Kështu përmbledhja klasike e Logjikës u hartua në nëntë pjesë, e cila më vonë me shekuj të tërë u mësua nëpër shkolla të ndryshme të botës. Tematika e këtyre ka të bëjë me terminologjinë, parimet, gjykimet, format e argumentimeve dhe demantimeve dhe, më shumë se çdo gjëje tjetër, i kushtohet vëmendje analogjisë. Edhe pse pas tij pati përpjekje të tjera të fushën e Logjikës, siç ishin stoikët, të cilët e ndanë logjikën nga metafizika dhe e futën në një dije mbi formën dhe gjuhën, megjithatë konceptet e Aristotelit mbi Logjikën vazhduan të kenë ndikim të madh qoftë në botën perëndimore, qoftë në botën islame.

pra disa prej tyre janë të mendimit se Logjika është pjesë e filozofisë, ndërsa disa të tjerë mendojnë se ajo është vetëm një mjet për mësimin e saj dhe për të menduar. Por Ibn Sina mendon se Logjiika është edhe pjesë e filozofisë por edhe mjet për të menduar dhe sipas tij, këtu nuk ekziston fare divergjencë. Megjithëse te dijetarët myslimanë i hasim qëndrimet e filozofëve të lashtë grekë, megjithatë më vonë shohim se dominon mendimi se Logjika është vetëm mjet, madje në shumë raste ajo definonet edhe si 'mjet i dijes'. (shih: Emiroğlu, İbrahim. Mantık. në: TDV İslâm Ansiklopedisi. Vëll. 28, Istanbul, 2003.)

Logjika e Aristotelit te myslimanët

Në fillim, kur myslimanët u drejtuan kah shkencat dhe dijet greke, përkthyesit më shumë qenë të prirur të përkthenin vepra nga fusha e mjekësisë dhe astronomisë. Por pa kaluar shumë kohë, me të dalë në pah polemikat intelektuale dhe doktrinare midis myslimanëve dhe ndjekësve të religjoneve të tjera,⁴ sidomos pas daljes në skenë të shkollës mutezilite,⁵ filozofia, veçanërisht Logjika gjeti përkrahës të mëdhenj të mesin e tyre. Ekzistojnë disa faktorë që shtyen myslimanët t'u drejtohen dijeve greke në përgjithësi dhe Logjikës në veçanti, disa nga të cilat janë:

1. Në vendet ku shtrihet feja islame, krishterimi, hebraizmi dhe fetë e ndryshme iraniane, doktrinën e tyre i mbronin me metodën logjike që e kishin huazuar nga grekët. Kjo gjendje i detyroi myslimanët që edhe ata argumentet për fenë e tyre t'i sistematizonin dhe kështu u drejtuan kah logjika greke.
2. Predikimet kuranore dhe profetike për nxënien e dijes, shkencës, mendimit, përdorimin e drejt të arsyes, si dhe shumë hadithe profetike që sugjerojnë dhe inkurajojnë myslimanët të mësojnë dijet e të tjerëve.
3. Në atë periudhë, përpos debateve doktrinare dhe fetare, ndjehej gjithashtu nevoja e ngritjes së nivelit intelektual dhe spekulativ dhe sidomos kërkohesh sofistikimi i metodave të polemizimit. Ky gjithashtu cilësohet një faktor i rëndësishëm që myslimanët të thellohen në dijet e grekëve.⁶
4. Logjicienët dhe filozofët myslimanë kishin arritur në rezultatin se gjuha

⁴ Sweetman, J. W. (1954). Islam and Christian Theology. Part I, vol. I. London. pp. 64-82.

⁵ shih: Esposito, John L. (2017). Fjalor i Oxfordit për Islamin. Logos A, Shkup. f. 235.

⁶ Emiroğlu, İbrahim (2006). Ana Hatlarıyla Klasik Mantık. Asa Kitabevi.s. 48-49.

arabe nuk kishte kapacitetin e nevojshëm semantik për transferimin e koncepteve filozofike greke, prandaj ata iu qasën thellësisht Logjikës së Aristotelit dhe treguan një përpjekje të madhe në përshtatjen dhe adaptimin e terminologjisë së Logjikës, gjë që rezultoi me krijimin e një tradite të pasur në fushën e Logjikës në botën islame.⁷

Duhet theksuar se Logjika greke në botën islame hyri nëpërmjet përkthimit të veprave të Aristotelit që në shek. VI hixhri (X miladi), dhe studiuesit janë të mendimit se libri i parë i plotë i Aristotelit ishte përkthimi i tri pjesëve të para të Organonit bashkë me Hyrjen (Esagoge) e Forforiusitnga përkthyesi i njohur Abdullah Ibn Muqaffa.⁸ Ndër përkthyesit e tjerë të Logjikës greke në botën arabe-islame llogariten edhe Juḥanna (Jahja) b. Bitrik, Abdullah b. N'aima el Himsi, ḥunejn b. Is'ḥaq, etj. Në arabisht qenë përkthyer të gjitha veprat e Aristotelit, madje edhe ato për të cilat ekzistonin dyshime nëse janë shkruar prej tij.

Aristoteli i arabizuar, edhe pse ndoshta nuk reflektonte sakt Aristotelin e plotë dhe të vërtetë grek, megjithatë që një përpjekje për transferimin e koncepteve dhe mendimeve nga një gjuhë në tjetrën, strukturat e të cilave dallonin shumë nga njëra-tjetra. Megjithëkëtë, duhet ta pranojmë se në të shumtën e rasteve, përkthimet e arabëve nga Aristoteli ishin shumë më besnike se shumë përkthime evropiane të veprave të tij.⁹

Përkthimet nga Aristoteli në lëmin e Logjikës (Organoni) kanë luajtur rol fundamental në krijimin e mendimit mysliman, madje ky ndikim

⁷ Safa, Zabiullah. (1378). Tarikh-e Ulum-e Aqli dar tamaddun-e Islami. Majid Publications. Teheran. s. 67.

⁸ Walzer, Richard. (1949). How Greek Science passed to the Arabs. Oxford. Oxford. p. 55.

⁹ Rescher, Nicholas. (1964). The Development of Arabic Logic. University of Pittsburgh Press. (Rescher, 1964:122)

depërtoi deri në dijen e Kelamit¹⁰ (teologjisë islame).

Logjika e përkthyer e Aristotelit, megjithë komentimet dhe zgjerimet që ia bënë logjicentë myslimanë, depërtoi thellë në mendimin filozofik dhe teologjik të mendimtarëve myslimanë, madje edhe struktura logjike e Aristotelit pati ndikim të madh edhe te metodologjia e jurisprudencës islame (Usul Fikhut). Nuk duhet lënë pa përmendur se teologët (Mutakal'limun) myslimanë e shfrytëzuan ndoshta më së shumti logjikën greke për mbrojtjen e bazave të besimit të tyre.¹¹

Përveç ndikimit të Logjikës së Aristotelit si shtyllë themelore në metodën e të menduarit të myslimanët, lirisht mund të themi se mbi gjysma e asaj që sot quhet filozofi islame është produkt i trashëgimisë filozofike të Aristotelit. Madje edhe filozofia neo-platoniste, e cila ka një influencë të madhe në krijimin e mendimit filozofik mysliman, të myslimanët ka depërtuar në emër të filozofisë aristoteliane. Ndikimi dhe rëndësia e Logjikës aristoteliane të myslimanët është aq e madhe, saqë konstatohet se “po të mos bëhej përkthimi i veprave të Aristotelit në gjuhën arabe, ndoshta nuk do të kishim filozofët e mëdhenj myslimanë si Kindi, Farabiu, Ibn Sina e Ibn Rushdi, dhe ndoshta si rezultat i kësaj, nuk do të ishin edhe filozofët perëndimorë si Albertus Magnus, Thomas Akuini, madje ndoshta

¹⁰ shih: Esposito, John L. (2017). Fjalor i Oxfordit për Islamin. Logos A, Shkup. f. 330

¹¹ Sipas Madkourit, mutekel'limët myslimanë duke filluar nga mutezilitët, esh'aritët, sidomos Imam al Haramajn Xhujeni dhe Abu Hamid Gazali në veprimtarinë e tyre intelektuale – kelamiste kanë qenë nën ndikimin e Logjikës së Aristotelit, të cilët medoemos kanë qenë njohës shumë të mirë të saj. Prof. Madkour konstaton se i pari që kishte vërejtur ndikimin e Logjikës greke te mutekellimët myslimanë qe Ibn Halduni, i cili thekson se Imam al Haramajn Xhujeni ka qenë i pari që e kishte futur metodologjinë e Aristotelit në dijet teologjike islame, konstatim ky i cili – sipas Madkour – është vërtetuar edhe në studimin e thuktë të orientalistit Macdonald. (për më tepër shih: Madkour, Ibrahim. (1375) La logique d'Aristote chez les Mutakallimun (versioni persisht i botuar në: Tahkikati Islami, Tehran, s.15).

perëndimorët nuk do të ishin njohur fare me trashëgiminë e lashtë filozofike greke”.¹²

Mendimtarët myslimanë, edhe pse e çmuan shumë Aristotelin¹³, aspak nuk hezituan që filozofinë e tij ta bëjnë objekt të kritikave të tyre. Edhe pse filozofët e parë myslimanë Farabiu dhe Ibn Sina patën kritikuar aty-këtu logjikën aristoteliane, megjithatë kritikët më të rreptë prej tyre qenë Suhreverdi (1154 -1191), filozof dhe mistik dhe Ibn Tajmije (1263 -1328), teolog. Sipas Ibrahim Madkour, Suhreverdi kryesisht nuk pajtohej me Aristotelin në dy tema mjaft të rëndësishme. E para: Sipas Suhreverdit, është shumë i vështirë realizimi i idesë së Aristotelit në lidhje me ‘sasinë’, ngase ideja e tij në këtë çështje mbështetet në konceptin e esenciales dhe quiditetit, koncepte këto që kanë të bëjnë me metafizikën. Si mund t’i definojmë cilësitë esenciale të një sendi të caktuar? Pastaj, si mund të sigurohemi se kemi përcaktuar të gjitha cilësitë e atij sendi? Kështu, reduktimi i një sendi mjafton deri aty sa të mund ta dallojmë dhe njohim atë nga sendet e tjera. Prandaj reduktimin shumë lehtë mund ta shfrytëzojmë në dije të ndryshme. Suhreverdi këtu ka parasysh rolin metodologjik të reduksionit dhe kjo qasje e tij është plotësisht e re në shkencën e logjikës. E dyta: Ai gjithashtu shpreh mospajtimin rreth katër formave të fatit, të cilat sipas tij, do të duhej të ishte vetëm një formë. Por megjithatë, Suhreverdi me Aristotelin më tepër nuk

¹² Khansari, Muhamed. (1383). *Manteq-e şouri*. Vëll. 1, Agah Publications. Tehran. s.13.

¹³ Filozofi dhe komentuesi i madh i veprave të Aristotelit, Ibn Rushd, në lidhje me Aristotelin shkruan: E falenderoj Zotin që këtë njeri (Aristotelin) e ka dalluar prej të tjerëve në përsosmëri dhe e ka vendosur në shkallën më të lartë të madhësisë njerëzore, në të cilën shkallë askush nuk arriti asnjëherë. Ndërsa në një vend tjetër thotë: Jam i mendimit se natyra këtë njeri (Aristotelin) e ka krijuar si model për të treguar fundin e përsosmërisë njerëzore. Ai është njeri, tek i cili e vërteta arriti kulmin. Shih: Horosani, Sherefuddin. (1367) *Dā'erat-ol-Ma'āref-e Bozorg-e Eslāmi*. Vëll. 22. Botim i Qendrës Dā'erat-ol-Ma'āref-e Bozorg-e Eslāmi, Tehran.

(<http://www.cgie.org.ir/fa/publication/volumes/63>) s. 606)

pajtohej për çështje definicionesh. Ndërsa Ibn Tejmije nuk kishte ndonjë kritikë të thellë logjike kundrejt Aristotelit, por më tepër luante një rol shkatërrimtar dhe ishte i mendimit që sa më parë duhet hequr dorë nga logjika dhe logjicienët. Ai qe një polemizues i zjarrtë, polemikat e të cilit nuk kishin ndonjë thellësi intelektuale, por më tepër bazoheshin në sulme diskredituese ndaj Aristotelit, nëpërmjet të cilit mëtonte t'i diskreditonte filozofët myslimanë.¹⁴ Kritika konstruktive ndaj logjikës greke, sidomos asaj aristoteliane, drejtuan edhe filozofët bashkëkohorë myslimanë si Muhammâd Iq̄bâll,¹⁵ Muhammâd 'Abid âl-Xhabir¹⁶ dhe Hasan Hanafi.¹⁷ Ndërsa shkaqet që në historinë e mendimit islam pati kritika ndaj logjikës së Aristotelit janë të llojllojshme dhe ka mendime të ndryshme për këtë çështje.¹⁸

Megjithatë, Logjika e Aristotelit gjeti mbështetje të pakompromis te myslimanët dhe në mënyrë sistematike u mësua nëpër shkollat dhe medresetë e tyre.¹⁹ Kështu dhe tradita e mësimit të saj shtrihej njëjtë me fenë islame nëpër rajone të ndryshme. Edhe në medresetë osmane, mësimit

¹⁴ Madkour, Ibid, f.55-56.

¹⁵ Iq̄ball. Muhammed. (2006) Ripërtrirja e mendimit fetar në Islam. Logos-A, Shkup. f. 16,18,164.

¹⁶ El-Cabiri, Muhammed Abid. (2001). Arap-İslâm Akılının Oluşumu. Kitabevi. Istanbul. s.266-293.

¹⁷ Hanafi, Hasan (1988) Min al aqida ila al-thaëra. Kahire. Vëll. 2, f. 197-198.

¹⁸ Disa nga shkaqet e kundërshtimit të myslimanëve ndaj logjikës janë: a) Përpjekja për ruajtjen e mendimit mysliman nga influenca e të huajve; b) Shqetësimi se mund të zinte vendin e dijeve islame; c) Habia apo frika nga forma e hyrjes së Logjikës në botën islame (fillimisht nga përkthyesit jomyslimanë) dhe konceptet themelore të saj (kategoritë, dialektika, analitika, induksioni, retorika, etj.); ç) Moskoordinimi i disa parimeve themelore të Logjikës me metodologjinë e hershme të kelamit; d) Qasja se Logjika e tkurrë mendimin dhe bllokoi rrugën e kënaqësisë (qasje e mistikëve); e) Qëndrimi mbi jodomosdoshmërinë e mbështetjes së dijeve në Logjikë, dhe ë) Qëndrimet emocionale (si dogmatizmi, paragjykimet, qasja pezhorative ndaj tjetrit) (shih: Emiroğlu, Ibrahim. İslâm Ansi-klopedisi, zëri Mantik, fq. 23) .

¹⁹ Badawi, Abdul-Rahman. (1978). Aristû 'inda'l-'Arab. Vekaletu-l Metbu'at Publications, Kuvajt. s. 23.

të Logjikës iu kushtua një kujdes i veçantë. Në plan-programet mësimore²⁰ në medresetë osmane shohim se krahas dijeve si Kur’ani, Tefsiri, Hadithi, Fik’hu, Akaidi, etj. mësohej edhe Logjika dhe sipas studiuesve, asaj i kushtohet një rëndësi tepër e madhe. Edhe pse nuk mund të kalojmë pa përmendur faktin se edhe në traditën e mendimit osman-mysliman, Logjika dhe në përgjithësi filozofia pati kundërshtarë të rreptë.²¹ Metodologjia e mësimimit të Logjikës, si dhe temat e saj në medresetë osmane nuk dallonin fare nga ajo greko-myslimane.

Temat e veprave të logjikës që mësoheshin në medresetë osmane përbëheshin nga dy tema kryesore: ‘Logjika e koncepteve’ (tasavvurat) dhe ‘logjika e gjykimeve’ (tasdikat). Në përgjithësi, studimi i fjalëve dhe diskutimi mbi kuptueshmërinë e fenomeneve në kuadër të logjikës së koncepteve vendosej në fillim të veprave të Logjikës, sepse një gjë e tillë mendohej si hyrje në çdo dije tjetër, ku bënin pjesë pesë nocionet, si dhe diskutimi mbi njohjen si qëllimi i saj. Ndërkaq pastaj rradhiteshin parimet e logjikës së gjykimeve (tasdikat), ndërsa qëllimi i tyre që analogjia dhe argumenti. Kurse pesë artet që ngërthenin teorinë e analogjisë ishin lënë krejt në fund. Kështu dhe nëntë pjesët e logjikës klasike qenë radhitur në një formë të ndryshme (krahas radhitjes së saj te grekët e lashtë, A.R.). Në këtë formë, sistemi i logjikës te osmanët ishte bërë klishe e logjikës së periudhës së mëparshme.²²

Veprat kryesore të Logjikës që mësoheshin nëpër medresetë osmane

²⁰ Rreth programeve mësimore në medreset osmane shih: Mefail Hızlı. *Osmanlı Medreselerinde Okutulan Dersler ve Eserler*. T.C. Uludağ üniversitesi ilâhiyat fakültesi dergisi. Cilt: 17, Sayı: 1, 2008 s. 25-46; Mustafa ŞANAL. *Osmanlı devleti'nde medreselere ders programları, öğretim metodu, ölçme ve değerlendirme, öğretimde ihtisaslaşma bakımından genel bir bakış*. Sosyal Bilimler Enstitüsü Dergisi. Sayı : 14 Yıl : 2003/1 (149-168 s.)

²¹ İzgi, Cevat (1997). *Osmanlı Medreselerinde İlim*. Cild 1, İz Yayıncılık. İstanbul. s.117.

²² Emiroğlu, İbrahim (2003). *Mantık*. Në: TDV İslâm Ansiklopedisi. Vëll. 28. s.23.

ishin: 'Isaguxhi e Abhariut, Kištaşu'l 'Afkâr fi taḥḥiḳi'l 'Asrar e Muhammed b. Eshref Samarkandit, Metali'ul 'Anvar e 'Urmevi dhe Sherḥu-sh Shemsije e Molla Fanarit. Meqë vepra 'Isaguxhi e 'Abhariut ishte kryesorja dhe kishte indikimin më të madh në mendimin e myslimanëve të Perandorisë Osmane (ku bënë pjesë edhe myslimanët shqiptarë), atëherë në këtë punim do të prezantoj vetëm këtë vepër dhe historikun e mësimin të saj të shqiptarët.

Meqë 'Isaguxhi e 'Abhariut është shkruar si vazhdimësi e traditës së 'Isaguxhive në trashëgiminë logjike të myslimanëve, do të ishte mirë në fillim të prezantohet shkurtimisht vepra e parë e këtij lloji, pra vepra Esagoge e Porporiusit.

Esagoge e Porporiusit

Më sipër u tha se veprës Organon të Aristotelit më vonë iu bashkangjiti edhe vepra Eisagoge (Eisagōgē) e Porporiusit (Porphyry).²³ Ky i fundit, këtë vepër e shkroi derisa po qëndronte në Sicili, me kërkesë të një pushtetari romak. Ky traktat, në të vërtetë, është komentim i koncepteve universale që njihen te Aristoteli, e që janë: gjinia, lloji, diferenca, aksidenca e veçantë dhe aksidenca. Në veprat e logjikës në gjuhën arabe dhe në ato latine të mesjetës, këta pesë koncepte quheshin edhe si 'idetë thelbësore'. Porporiusi në këtë traktat diskuton për ekzistencën e pesë koncepteve thelbësore dhe për lidhjet e tyre mes veti, por nuk lëshohet shumë në analiza më të thella. Ai në këtë vepër, duke u mbështetur në të dhënat dhe idetë e Aristotelit të shtruar në vepra të ndryshme të Logjikës dhe Metafizikës dhe duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe një stil që i shkon Logjikës, sqaroi edhe më tej pesë konceptet thelbësore aristoteliane. Duhet vënë theksin se këta koncepte nuk janë të

²³ Porporius (Porphyry) (304-234 p.e.s.) qe filozof neoplatonist, nxënës i Plutinit i cili kishte përgatitur e redaktuar veprat e mësuesit të tij.

krijua prej Porporiusit, siç mendojnë shumë njerëz.²⁴ Edhe pse kjo vepër nuk sillte ndonjë risi të veçantë, por pati fatin që të komentohet dhe interpretohet nga shumë interpretues të veprave të Aristotelit. Me këtë vepër të shkurtër, Porporiusi u bë i njohur po aq sa profesori i tij Plutini dhe e shtriu ndikimin e tij në rrjedhat e mëpastajme të filozofisë në Lindje dhe në Perëndim. Esagoge aq shumë përfitoi nam dhe rëndësi sa që në Mesjetë arriti të shndërrohet në referencën kryesore për lëndën e Logjikës. Ajo u përhap edhe në Lindje, duke u përkthyer në fillim në gjuhën sirianite dhe pehlevite (përsishtja e vjetër) dhe më pas në gjuhën arabe dhe kështu pati një shtrirje të gjerë edhe në mesin e filozofëve myslimanë²⁵. Përkthyesi i saj nga sirianishtja në arabisht qe Abu Uthman Dimeshki (v. 914). Ndërsa 'Isaguxhia më e njohur te myslimanët është ajo e Ethiruddin 'Abhari'ut (v. 1265).²⁶

'Isaguxhia e Athiruddin al-'Abhariut

Vepra e "âr-Risâlâ âl-âthârijjâ *fî-l-Mânîk'*" apo në original 'Isaguxhi

²⁴ Emiroğlu, İbrahim (2006). Ana Hatlarıyla Klasik Mantık. Asa Kitabevi.s.37.

²⁵ Në mesin e filozofëve myslimanë që shkruan dhe komentuan 'Isaguxhinë e Porporiusit janë: Jakub b. Ishak El Kindi, Kitab fi'l medhal bi – istifa'I-ḳavli fih, Risale fi'l-medhali'l mantiḳi bi'htisharin ëe ixhaz dhe Risale fi'sh – shavti'l –ḥamse; Ibnu't Tajjib Es Serhasi, Ihtisharu Kitabi 'Isaguxhi; Muhammed b. Zekerijja er Razi, Kitabu 'Isaguxhi dhe Ebu Nasr Farabi, Kitabu 'Isaguxhi ej el-Medhal. Duhet theksuar se edhe Ibn Sina pjesën e Logjikës së Shifa-s e fillon me një 'Isaguxhi (Hyrje), ku polemizon me mendimet dhe idetë e Porporiusit.

²⁶ Nuk ekzistojnë shumë të dhëna për jetën e Ethiruddin 'Abhariut. Disa studiues mbrojnë qëndrimin se ai ka lindur në Musul, ndërsa disa të tjerë në Isfahan ose Zenxhan, por ata pajtohen se ai i takon një familjeje nga Samarkandi. Ekzistojnë gjithashtu dyshime për datat e lindjes dhe të vdekjes së tij. Mësimet e para i mori në Musul dhe më pas ato i vazhdoi në Horosan dhe Bagdad. Përveç 'Isaguxhisë, ai shkroi edhe 11 vepra të tjera, ku disa prej tyre janë: Hidajetu-l ḥikme, Tenzilu-l -efkar fi ta'dili'l – esrar, Keshfu'l ḥaḳaiḳ fi tahriri-d – deḳaiḳ, etj. Vlen të theksohet se ai në literaturën islame njihet si filozof, astronom, matematikan, logjicien dhe teolog. Për jetën dhe veprën e tij më gjerësisht shih: İslâm Ansiklopedisi, zëri: Ebharî, Esiruddin). Ünlü Türk Mantıkçısı Ebherî ve Mantık Kuralları Risâlesi", përktheu Hüseyin SARIOĞLU. İlmî Araştırmalar, XI (İstanbul 2001), 151-165.

(arabisht: ايساغوجى في علم المنطق, i transliteruar si *Īsāgūḡī*) siç njihet më shumë, e shkruar nga 'Āthīru-d-Dīn al-Ābhārij, është vlerësuar si adaptim i veprës së Porporiusit, si komentim dhe si përkthim i kësaj vepre.²⁷ Në këtë vepër janë përmbledhur gati të gjitha temat e Logjikës së asaj kohe dhe kjo është arsyeja e të gjithë atyre komentimeve dhe shkrimit të margjinave të kësaj vepre. 'Isaguxhie' Abhariut ka përmbledhur të gjitha temat e Organon të Aristotelit, 'Isaguxhinë e Porporiusit, por temat i ka të radhitura sipas veprave të Farabiut dhe Ibn Sinasë, ndërsa konceptin e shënjueshmërisë (delalet) e trajton përpara pesë koncepteve thelbësore të trajtuara nga Porporiusi. Ndërkaq ngjashmëria e vetme e veprës së Abhariut me atë të Porporiusit është trajtimi i koncepteve thelbësore të veprës 'Isaguxhi të Porpurisit edhe pse shumë shkurt. Duke i qëndruar besnik traditës aristoteliane të Logjikës, 'Abhariau njëjt si Ibn Sina veprën e tij e fillon me analizën e gjuhës dhe fjalës e jo të objekteve. Pastaj trajton llojet e fjalës dhe definimit të definicionit nga pesë fjalë, dhe kalon te llojet, aksidencat e veçanta, diferenca, analogjia, analogjia kategorike dhe ajo hipotetike, hipoteza, dhe pasi diskuton për karakteristikën e secilës, kalon te argumentimi, te mbështetja e argumentit në dije të saktë dhe më pastaj diskuton për të vërtetën, hipotetiken, dhe libri përfundon me definicionet e analogjisë dialektike, retorike, poetike dhe sofistike. Brenda librit hasim pjesët e logjikës të radhitura në mënyrë sistematike, ku njihemi me përshkrimin, definimin dhe analizën e shkurtër të të gjitha koncepteve të Logjikës. Gjithashtu pas çdo definicioni dhe përshkrimi jepet edhe shembulli për te.

²⁷ Atademir, Hamdi Ragip. (1948). Porphyrios ve Ebheri'nin Isagoci'leri. DTCCFD, VI/5. s. 464.

Faksimile nga faqja e parë e librit 'Isaguxhi e 'Abhariut, e marrë nga biblioteka e Mulla Fejzullah ef. Salihu nga fshati Geraj/Preshevë



Prandaj, vepra 'Isaguxhi e 'Abhariut, për nga struktura dhe përmbajtja, më shumë i ngjan 'Isaguxhisë (Hyrjes) së Ibn Sinasë sesa 'Isaguxhisë së Porporiusit,²⁸ por megjithatë ajo trajton edhe pesë konceptet thelbësore të 'Isaguxhisë së Porporiusit dhe mund të thuhet se është vazhdim i kësaj tradite në fushën e Logjikës. Vlen të theksohet se pas 'Abhariut, të gjitha

²⁸ Bingöl, Kuddüs. (2010). "Türk-İslam Kültür Dünyasında İsağojî", İslami İlimler Degisi. Yıl 5, sayı 2., 2010. s.169.

studimet dhe komentimet janë për-qendruar në veprën e tij dhe ajo u komentua, u përkthye dhe u botua në shumë gjuhë të botës. Komentimi më i njohur i saj është “El Feva’idul - Fenariyye” i Molla Fenari’ut dhe “El-Muṭala” i Muhammed el-Ensari el-Kaḥiri’iut. Në latinisht është përkthyer nga P. Thomas Novariensis dhe është botuar në Romë në vitin 1625. Duhet përmendur se kjo vepër është komentuar edhe nga dijetari boshnjak Mustafa Ejubović (1651-1704), i cili pas kthimit nga studimet në Stamboll, e kishte përkthyer dhe e kishte bërë të mundur atë të mësohet nëpër medresetë e Bosnjës dhe Hercegovinës.²⁹ Duhet theksuar se në Bosnjë, logjika e Aristotelit gjithashtu është mësuar edhe në medrese, por edhe nëpër shkollat e kishave ortodokse³⁰, gjë që mund të thuhet se është mësuar edhe në medresetë dhe kishat ortodokse në trevat shqiptare. Kjo vepër nga gjuha greke në atë arabe është përkthyer edhe nga Mehmed Esad Janina (Mehmed Esad b. Ali b. Osman el-Yanyevi (v. 1143/1730), një dijetar e njohës i madh i filozofisë dhe logjikës me prejardhje shqiptare. Esad Janina këtë përkthim të Esagoges bashkë me një përmbledhje nga pjesët e Kategorive, Peri Hermeneias, Analitikat I dhe II të Aristotelit e ka titulluar “Terxhimetu-sh Sherḥi’l Anvar”. Këtë vepër ai e ka përkthyer duke u bazuar në komentimin e Ioaniss Kuttiniusit, por ka edhe komentime dhe analiza të tij personale.³¹

²⁹ Kundakçi, Deniz. (2012) “Mantık ve Felsefe Eğitiminin Bosna-Hersek'teki Tarihsel Gelişimi”. Kastamonu Üniversitesi Eğitim Fakültesi Dergisi Cilt: 20, No:2, s. 689-700. s.692.

³⁰ Ibrulj, Nijaz. (2009) Bosnia Porphyriana: An outline of the development of Logic in Bosnia and Herzegovina. SURVEY - Periodical for Social Studies. No: 1. Page: 109-165. p.111.

³¹ Sarikavak, Kazim (2013). Yanyali Esad Efendi. Në: TDV İslâm Ansiklopedisi. Vëll. 43. s.323.

Për traditën e mësimi të kësaj veprë në medresetë e Ballkanit shkruan edhe studiuesi i njohur bashkëkohor, Shehab Ahmed, ku thotë: “Nga Ballkani në Bangladesh, studentët e medreseve studionin tekstet të ngjashme, si: Veprat themelore të Logjikës siç është ‘Isaguxhi e ‘Abhariut.’”³² Kjo veprë në medresetë e Perandorisë Osmane, pra deri në themelimin e Republikës së Turqisë, ka qenë teksti kryesor i lëndës së Logjikës (Islam Ansiklopedisi, zëri ‘Isaguxhi), ndërsa në botën shqiptare ka vazhduar të mësohet edhe përgjatë shekullit XX.³³ Është për t’u theksuar se kjo veprë është mësuar edhe në Universitetin e Az’harit deri në vitet e 50-të të shek. XX.

Logjika e Aristotelit në medresetë shqiptare

Me shtrirjen e Perandorisë Osmane nëpër rajonet tona, njëkohësisht ndërtoheshin dhe objektet fetare dhe arsimore të kësaj perandorie, siç janë xhamitë, teqetë dhe medresetë, ku këto të fundit qenë shtyllë e arsimit në perandori.³⁴ Padyshim se medresetë e trojeve tona funksiononin sipas planeve dhe programeve organizative dhe mësimore të medreseve të Perandorisë Osmane. Po ashtu tekstet mësimore, metodologjia e mësimi dhe organizimi i medreseve shqiptare nuk dallonin aq nga medreset osmane. Huluntimi nëpër bibliotekat e dijetarëve myslimanë shqiptarë të

³² Ahmad, Shahab (2015). What Is Islam? - The Importance of Being Islamic. Princeton University Press. s.76.

³³ Ende nuk kam të dhëna nëse kjo veprë është komentuar dhe përkthyer në shqip nga ndonjë dijetar shqiptar. Ndërsa talebet e medreseve në trevat shqiptare kanë pasur rastin të mësojnë këtë veprë bashkë me komentimin në turqisht apo shqip që ia bënin mësuesit (muderrizët), por të komentuar në shkrim nuk e ka bërë, aq sa kam njohuri, asnjëri prej tyre. Nga intervista me disa hoxhallarë, ish-talebe të merdeses së vjetër të Preshevës, u njoftova se hoxha-mësuesi i tyre i ka përkthyer në shqip ato pjesë të cilat këta nuk kanë arritur t’i kuptojnë në arabisht dhe turqisht. Ndërsa kopjet që i posedonin hoxhallarët e Preshevës janë botime të ndryshme të shtypura në Stamboll.

³⁴ Demir, Nexhati. (2013). Arsimi dhe edukimi në Kosovë përgjatë viteve 1877-1912. Revista Hikmet, numër 1 dhe 2. Prishtinë. f.23.

gjeneratave të vjetra, si dhe librat e botuar dhe dorëshkrimet nëpër arkivat dhe bibliotekat shqiptare, dëshmojnë se librat që janë mësuar nëpër medresetë e botës islame, janë mësuar edhe tek ne³⁵. Në mesin e këtyre shohim edhe librin ‘‘Isaguxhi’’ të Abhariut. Pra, ekzitojnë fakte empirike se vepra ‘Isaguxhi e Esiruddin Abhariut është mësuar edhe në medreset shqiptare, madje në rajonin e Preshevës është mësuar deri në vitet 80-të të shekullit të kaluar. Këtë vepër e posedon gati secili talebe i medreseve të vjetra. Ajo mund të haset edhe në arkivat e në bibliotekat tona.

Në bazë të ixhāzetnāmeve që kemi marrë në shqyrtim dhe burimeve të tjera, kemi parë se ndër veprat që janë mësuar nëpër rushdijet dhe në idādijet, dhe sidomos në medresetë tona janë edhe veprat: ‘Isāguxhī’ - Vepër nga logjika, në gjuhën arabe, e autorit Athīru-d-īn Mufaḍḍal b.‘Umār āl-‘Abhārī (vdiq më 663/1265) dhe, ‘Fenārī’, që është një koment i veprës ‘Isagūxhi’ të Ethiruddīn el-‘Ebhariut, të cilin koment e ka bërë Şemsuddīn Muhammed b. Hamza el-Fenārī (vdiq më 834/1430). Vepra njihet me emrat ‘El-Fevāidu ‘l-Fenāriye’ ose ‘Sherh el-Isāguxhī lil-Fenārī’. Një kopje e kësaj të fundit në dorëshkrim ruhet në Arkivin e Kosovës, kopjimin e së cilës e ka bërë Muhammed b. haxhi Hasani në vitin 977/1570.³⁶

Medresja e Preshevës apo siç njihet si Medresja e hfz. Nexhatisë, e themeluar nga hfz. Nexhati Mehmeti, i cili si një trashëgimtar i një tradite të pasur hoxhallarësh e dijetarësh, qe shkolluar edhe në medresenë e njohur

³⁵ Në mesin e librave të bibliotekës së trashëguar nga gjyshi im, Mulla Rexhep Rexhepi, por edhe të hoxhallërve tjerë, janë edhe librat që janë mësuar nëpër medrese, si: *Emsile* (pa autor), *Bina* (pa autor), *Maḳsud Mulṭeḳa* e autorit Ibrahim b. Muhammed el-Halebi, *Izzi* e autorit Izeddin ‘Abdulveḥab b. Ibrahim ez-Zinxhani, e shumë libra tjerë. Po ashtu, edhe në bibliotekat e hoxhallarëve më të vjetër, shumë nga të cilët tashmë kanë ndërruar jetë (si hfz. Nexhati Ahmeti, Mulla Fejzullah Salihu dhe Mulla Nazmi Mehmeti) ndodhen librat kryesorë të medreseve të asaj kohe, pa harruar edhe shumë libra të tjerë të dijeve islame.

³⁶ Mehmeti, Sadik. (2008) Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës, Prishtinë. f.106.

Medah të Ataullah Efendiut në Shkup,³⁷ arriti të shkollojë tri gjenerata talebesh, prej së cilës dolën dijetarë dhe myderriz të shquar të kësaj treve. Më i dalluari prej tyre qe Mulla Fejzullah Salihu (në popull i njohur si Mulla Fejza) tek i cili mësuan një numër i konsiderueshëm talebesh.³⁸

Këta hoxhallarë përpos veprave të tjera që i kanë mësuar e studiuar, flasin edhe për 'Isaguxhinë e 'Abhariut. Krahas kësaj vepre, ata prej librave të lëndës së Logjikës (Mantik) përmendin edhe Mugni't- ʔul'lab, si komentim të 'Isaguxhisë. Sipas tyre, edhe kjo vepër, ashtu si librat e tjerë, është lexuar në gjuhën arabe, pastaj është komentuar dhe shpjeguar në gjuhën turke dhe shqipe. Ndërsa, ata më shumë kanë qenë të përqendruar të lexojnë dhe mësojnë komentimin e 'Isaguxhisë, pra librin Mugni't- ʔul'lab³⁹. *Mantikun (Logjikën) e mësonim*, siç thonë ata, *për me mund me dallu të mirën nga e keqja, hakun prej johakut dhe të drejtën nga e shtrembëra*. Ajo që kanë mbajtur në mend nga kjo libër është zberthimi i emrit 'Isaguxhi, të cilin e thonë në këtë mënyrë: Is ايس (-ente, agu(اغو) – ene dhe exhi ose xhi (اخي) – fi hadhel meqan. (dmth: Is-ti, agu-unë dhe xhi-në këtë vend)⁴⁰. Një gjë të tillë e hasim edhe në librin Mugni't-ʔul'lab, por sigurisht që një zberthim apo interpretim i tillë i emrit 'Isaguxhi është i

³⁷ Bislimi, Taxhedin. (2011). "Medreseja Medah" e Ataullah Efendiut dhe nxënësit e saj. Shkup, f. 61.

³⁸ Prej të cilëve kam intervistuar Mulla Shenasi Fejzullahin, Mulla Xhemal Musliun, Mulla Behxhet Idrizin dhe hfz. Avni Ahmetin nga komuna e Preshevës dhe Bujanocit.


³⁹ Stili i veprave klasike në logjikë dhe filozofi ka qenë që të shkruhej me fjali sa më të shkurtra dhe në mënyrë sa më të përmbledhur e më të ngjeshur. Prandaj këto vepra duhej të mësoheshin nga ndonjë mësues i cili po ashtu ka mësuar te ndonjë mësues tjetër, e kështu më radhë. Ishte e pamundur që veprat në fjalë të kuptoheshin pa ndihmën e një mësuesi, apo pa lexuar ndonjë komentim ose margjinat (hashije) të shkruara në këto vepra.

⁴⁰ Këtë ma kanë thënë gjatë intervistës Mulla Shenasi Fejzullahin, Mulla Xhemal Musliun dhe hfz. Avni Ahmetin.

gabueshëm, ngase siç është thënë edhe më sipër, 'Isaguxhi është një theks arab i fjalës greke "eisaguge" në kuptimin e hyrjes. Interpretime të tilla të paqëndrueshme mund të shihen në shumë komentime dhe analiza që gjatë historisë i janë bërë kësaj vepre.

Në margjinat e shkruara të disa botimeve të kësaj vepre, edhe pse ky emër i atribuohet çdo libri përgatitor ose hyrës për ndonjë libër tjetër më të rëndë për t'u kuptuar, megjithatë përmendet se 'Isaguxhi është term i lëndës së Logjikës. Pastaj, edhe pse është përmendur në disa burime se kuptimi i kësaj fjale është 'Hyrje', përsëri diku-diku shohim se janë dhënë edhe kuptime të tjera, madje është pretenduar se 'Isaguxhi' ka qenë emër i një filozofi ose i një nxënësi të një filozofi, madje janë hedhur edhe ide se kjo fjalë është nga gjuha sirianite e jo greke e gjepura të tilla të paqëndrueshme.⁴¹

⁴¹ Atademir, Hamdi Ragip. (1948). Porphyrios ve 'Abhari'nin Isagoci'leri. DTCFD, VI/5. s. 467.



Faksimile nga faqja e gjashtë e librit “Mugni't-ṭul’lab” e marrë nga biblioteka e

Mulla Fejzullah ef. Salihu nga fshati Geraj/Preshevë

Metoda e mësimit të kësaj vepre njëjtë si veprat e tjera, ka qenë e tillë: në disa raste mësime të mësimdhënësi e ka lexuar tekstin në arabisht, pastaj e ka analizuar atë fjalë për fjalë në aspektin filologjik, dhe në fund e ka komentuar në gjuhën turke ose në shqipe, kurse ndonjëherë teksti është

lexuar nga ndonjë talebe dhe më pas është komentuar nga mësimdhënësi. Sipas këtyre hoxhallarëve, mësimi i këtyre veprave si kjo e ‘Isaguxhisë, ndihmon të kuptuarit e teksteve fetare islame, sepse pa mësuar mantikun (logjikën), *ilmul-bejanin* (retorikën) e lëndë të tjera si këto, nuk mund ta kuptojmë si duhet Kuranin dhe hadithin.

Prezenca e kësaj vepre në bibliotekat e secilit hoxhë të shkolluar në sistemin e medreseve të vjetra është një dëshmi për pozitën e lartë që ka patur ajo në syllabuset e atyre medreseve dhe një gjë e tillë më shtyn të mendoj, sidomos nëse kihen parasysh edhe veprat tjera mbi Logjikën në bibliotekat e tyre, rreth rëndësisë që ata i jepnin Logjikës në shkollimin, mendimin dhe më pastaj në veprimtarinë e tyre fetare.⁴² Por, gjatë bisedave me këtë gjeneratë të fundit të talebeve të medresesë së vjetër të hfz. Nexhatisë, të cilët tashmë janë në një moshë të shtyrë, për mua që e pamundur të kuptoj ndikimin e veprës së ‘Isaguxhisë dhe sidomos te këta persona të has në gjurmët e Logjikës aristoteliane. Po ashtu, është interesant fakti se ata ishin të njohur me filozofët dhe logjicienët më të mëdhenj të botës myslimane, si Kindi, Farabiu, Ibn Sina, Rrazi, Taftazani etj., madje atyre u kujtohej dhe Aristoteli (Aristu, siç thonë ata). Duke pasur parasysh kushtet dhe rrethanat politike të kohës kur kjo medrese funksiononte, pa dyshim se duhet ulur pritjet për ndikimin e ideve dhe koncepteve të mëdha logjike-filozofike. Por nëpër ligjëratat dhe derset e këtyre hoxhallarëve dhe sidomos në bisedat që kam zhvilluar me ta, merret vesh se ata kanë njohuri për dialektikën, retorikën, estetikën dhe analogjinë. Për këtë ata mund të kuptojnë shumë mirë veprat klasike arabe, veçanërisht

⁴² Një gjë e tillë aspak nuk mund të vërhet tek hoxhallarët e mëvonshëm të shkolluar nëpër vendet arabe, sidomos në ato të Arabisë Saudite. Për fat të keq, te kjo shkollë teologjike mbizotëron një frymë armiqësore kundrejt Logjikës dhe Filozofisë, dhe si rezultat, myslimanët shqiptarë janë duke u ballafaquar me interpretime tepër radikale dhe anakronike të fesë tyre.

poezinë dhe prozën klasike arabe. Edhe një gjë nuk duhet harruar, Logjika dhe Filozofia që mësohej në atë kohë, në të gjitha medresetë ishte në shërbim të kelamit dhe apologjisë fetare.

Përfundim

Logjika e Aristotelit gjeti shtrirje të madhe në mesin e medreseve dhe dijetarëve myslimanë, kurse veprat e tij u përkthyen dhe u komentuan herë të tëra. Kështu ai pati ndikimin më të madh në mënyrën dhe metodën e të menduarit, të argumentuarit dhe të krijimit të koncepteve dhe ideve të mendimtarëve myslimanë. Një gjë të këtillë padyshim se shumë pak mund ta hasim në traditën mistike të botës islame. Vepra që e bëri edhe më të kuptueshme dhe më të njohur Logjikën e Aristotelit te myslimanët, padyshim se qe 'Isaguxhi e Porporiusit, e cila u përkthye, u komentua, madje edhe u shndërrua në model të shumë veprave të dijetarëve myslimanë në fushën e Logjikës. Duke pasur për model këtë vepër, filozofët dhe dijetarët myslimanë shkruan 'Isaguxhi të tjera, ku më e njohura prej tyre është ajo e 'Athīru-d-đīnāl-'Abhariut. "ar-Risāla āl-Athirije fi-l-Mantīq" apo 'Isaguxhi' e 'Abhariut qe vepra më e komentuar dhe e përkthyer në gjuhët e Lindjes dhe të Perëndimit dhe qe bërë tekst mësimor nëpër medresetë e myslimanëve anembanë botës islame. Kjo vepër gjithashtu mësohej edhe në medresetë e Perandorisë Osmane, si vazhdimësi e tyre edhe në medrsetë shqiptare. Vepra e 'Abhariut ishte mësuar deri vonë në medresenë e hfz. Nexhatisë në Preshevë dhe në talebet e tij edhe sot e kësaj dite mund të flasin për të. Është tepër e vështirë të identifikohet sasia dhe cilësia e ndikimit të kësaj vepre në mënyrën e të menduarit të këtyre hoxhallarëve. Megjithatë, Logjika që mësohej në këto medrese ishte në shërbim të teologjisë dhe apologjisë fetare dhe jo ndonjë veprimtari e pavarur intelektuale.

Aristotle's Logic in Albanian Madrasas

Abdulla Rexhepi *

Abstract

Muslim philosophers borrowed Logic like many other sciences from the ancient Greeks, especially from Aristotle. Aristotle's thoughts and opinions on Logic were gathered by his students in a philosophical work named "Organon". In the third century Prophyrius Tyrius, the Neo – Plotinian philosopher wrote an introduction to the first part of "Organon", to the Category part which he titled 'Esagoge'. The best known of which was the one of Ethiruddin 'Abhari (1276), whose work is known as "Esagoge" or "Risale Ethirije fi'l Mantıq". This work, along with other works in the field of Logic, was part of the teaching program in Albanian madrasas, which existed till the end of the last century. In this paper, first I will introduce and analyze the work Esagoge of 'Abhari and then I will try to talk about learning this work in Albanian madrasas, focusing on the Hafiz Nexhati's Islamic school in Preshevo.

Keywords: Logic, Aristotle, Esagoge, 'Abhari, Ottoman - Albanian madrasas, Madrasa of Hafez Nexhati.

* Prof. Ass. Dr. of Persian language & literature and Ottoman-Turkish language, Department of Oriental Studies, University "Hasan Prishtina", Pristina.

Nehat Krasniqi -Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes kombëtare, Prishtinë (Instituti albanologjik) Prishtinë 2017, 575 faqe

Me këtë disertacion të doktoratës, i mbrojtur më 2010 në Degën e Historisë të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, N. Krasniqi promovohet në mesin e osmanistëve shqiptarë që merren me historinë shqiptare gjatë sundimit osman. Më parë, në Prishtinë, më 2011 ai botoi veprën me punimet zgjedhura me titull "*Kontribute albanologjike: studime dhe dokumente historike dhe letrare të periudhës osmane*", të cilën e hartoi në sajë të përvojës së tij të gjatë si përgjegjës për koleksionin e dorëshkrimeve orientale në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të të Kosovës (1983-2014).

Me këtë disertacion rumbulla kësohet për herë të parë në gjuhën

shqipe një monografi në këtë temë të ndjeshme, e cila realizohet pas disa punimeve të botuara në Shqipëri e në Kosovë në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar (Osman Myderrizi, Hasan Kaleshi, Idriz Ajeti, Mark Krasniqi, Muhamed Pirraku, Feti Mehdiu, Muhamed Mufaku etj.).

Me "ndjeshmërinë" e kësaj teme N. Krasniqi merret në mënyrë kritike në *Parathënie*, ku thotë se pos "ndikimit negativ" që "ka ushtruar idelogjia dhe ish-sistemi komunist", është edhe një kompleks tjetër që "edhe sot vazhdon të jetë i pranishëm aty-këtu për konceptin kulturor, duke qënë i prirë të bënte dallime joparimore ndërmjet kulturave, duke mbiçmuar njëren apo duke përçmuar tjetrën". Përveç kësaj, "rol të veçantë në krijimin e një qëndrimi përbuzës ndaj trashëgimisë kulture shqiptare me ndikime orientale islame ka luajtur, gjithsesi, prania e ideve eurocentriste, apo kocepti antiislam, respektivisht antiturk ndër ne, në të kaluarën e afërt"(f.27).

Përballë këtij "qëndrimi negativ" autori mblodhi materiale të

bollshme nëpër arkiva dhe biblioteka në Kosovë, Shqipëri, Bosnje, Bullgari e Turqi për të dëshmuar "zhvillimin e kulturës shqiptare me ndikime orientale" si proces kombëtar, e jo si proces i imponuar nga jashtë. Kështu, në kaptinën e parë "*Sfondi historik i ndikimeve orientale në kulturën shqiptare*" (f.35-94) Krasniqi prezanton sfondin historik deri në shek. XVIII, përkatësisht pushtimin osman, gjithashtu prezanton shoqërinë dhe institucionet osmane, gjendjen kulturore të shqiptarëve në kohën e pushtimeve osmane, si dhe procesin e islamizimit të shqiptarëve duke e lidhur me integrimin e tyre në institucionet e reja (sadrizmet, shejhulislamët etj).

Në kaptinën e dytë "*Bazat ekonomike shoqërore dhe politike të zhvillimit të kulturës shqiptare në fillim të shek. XVIII*" (f.95-186) na del një kthesë domethënëse me dështimin e rrethimit të Vjenës dhe me ofensivën e ushtrisë austriake nëpër Ballkan më 1689, duke shaktuar shumë dëmë materiale e demografike në viset shqiptare, kurse në

kundëroftivë më 1690 morën pjesë shumë komandantë e ushtarë shqiptarë. Kështu në bazë të saj, teza kryesore e autorit del se asokohe "në trojet etnike shqiptare dejtuesit e pushtet lokal dhe komandantët e forcave të sanxhaqeve shqiptare kanë qenë të gjithë shqiptarë" që dëshmuar veten në kundëroftivë, tani ishte krijuar një "fisnikëri" shqiptare që u kujdes për "zhvillimin e kulturës shqiptare me ndikime orientale" në viset shqiptare me tituj të ndryshëm (bejlerë e pashallarë) prej fillimit të shek. XVIII e deri në vitet '40 të shek. XIX. Këtë proces autori e zberthen në kaptinën e tretë me titull "*Roli i fisnikërisë vendëse në zhvillimin e kulturës shqiptare me ndikime orientale islame*" (f.187-226), ku bëhet fjalë për zhvillimin e esnafëve dhe ekonominë e tregut, për forcimin politik dhe ekonomik të feudalëve shqiptarë dhe krijimin e pashallëqeve shqiptare autonome deri në eliminim e tyre në gjysmën e parë të shek.XIX. Roli i kësaj "fisnikërie" shqiptare, me krijimin e bazës materliale të kulturës shqiptare, me

ndikimet orientale duket më shumë në kaptinën e katërt "*Themelimi i institucioneve arsimore, edukative dhe kulturore*" (f.227-258), përkatësisht me ndërtimi i shkollave fillore (mejtetet), shkollave të mesme dhe të larta (medresetë) dhe bibliotekat etj.

Në pjesën e dytë të veprës, ku kemi një qasje mjaft profesionale, është kaptina e pestë "*Gjuha letrare shqipe dhe gjuhësia shqiptare në krijmtarinë almiado*" (f.263-274), ku autori paraqet karakteristikat dhe trendet zhvillimore të kësaj letërsie, si dhe veprat leksikografike e gramatikore dhe autorët e tyre. Kaptina e gjashtë "*Letërsia shqiptare me ndikime orientale*" (f.281-261) paraqet kontribut origjinal të autorit. Në këtë kaptinë autori prezanton së pari "Letërsinë shqiptare të divanit dhe përfaqësuesit e saj", përkatësisht 35 autorë të njohur e të panjohur, kurse në vijim "letërsinë shqipe almiado dhe përfaqësuesit e saj", ku prezantohen 32 poetë në mesin e të cilëve disa prezantohen për herë të parë.

Me koncept më të gjerë kulturor, autori, në kaptinën VII

"Urbanistika dhe arkitektura" (f.425-455) zbërthen kontributin e "fisnikërisë" shqiptare në ndërtimin e objekteve sakrale (xhamitë, medresetë dhe teqetë) dhe të objekteve profane (bezistanet, hanet, karavansarajet, urat, kullat e sahatit etj), ndonëse këtu përfshihen edhe figura joshqiptare që kanë ndërtuar një pjesë të këtyre monumenteve.

Në kaptinën e fundit "*Kultura popullore me ndikime orientale*" (f.457-475), autori trajton ndikimet orientale. Këtë kaptinë e ndan në tri nënkaptina: *Folklori shqiptar, Arkitektura popullore dhe Ambienti jetësor dhe besimet popullore*. Me gjithë vlerën që ka kjo kaptinë, na duket se nuk e ka vendin këtu, nëse kihet parasysh korniza e caktuar kohore e veprës (shek. XVIII dhe gjysma e parë e shek. XIX). Me fjalë të tjera, ndikimet orientale në folklorin shqiptar dhe në besimet popullore që përmenden, janë më të hershme dhe nuk kemi ndonjë qasje që t'i atribuohen asaj kornize kohore. Përjashtim bën pjesa që ka të bëjë me arkitekturën popullore, ku mund të

përfshihen lagjet, sarajet e shtëpitë e tjera të ndërtuara brenda asaj kornize kohore.

Në fund, duhet të theksohet se kjo monografi vjen si rezultat i hulumtimeve në disa arkiva e biblioteka me koleksione të dorëshkrimeve orientale në Kosovë, Shqipëri, Turqi, Bosnje e në Kroaci. Nga ana tjetër, na duket se ishte dashur në *Parathënie* të përmenden edhe autorë të tjerë që janë marrë me këtë tematikë në gjysmën e

dytë të shek. XX, ndonëse autori citon shumicën e punimeve të tyre (O. Myderrizi, H.Kaleshi, I.Ajeti, M. Pirraquetj.) Po ashtu, meqë libri sjell risi për shkrimtarë shqiptarë të panjohur që krijuan në gjuhën shqipe me shkronja arabe, vërehet mungesa e faksimileve të faqeve të para të veprave të tyre në dorëshkrim, por na mban shpresa se kësaj fushe autori do t'i kushtojë një monografi të veçantë.

Muhamed Mufaku

Amina Šiljak-Jesenković, Odrazi ljubavnih mesnevoja u stihovima bošnjačkih divanskih pjesnika, Orientalni institut u Sarajevu, Sarajevo, 2016, XX + 326 f.

Roli i letërsisë së poeteve osman me prejardhje ballkanike në kanonin e letërsisë klasike natyrisht se është një temë e cila ka rëndësi të veçantë për çdo popull që ka kontribuar në ndërtimin e tij.

Studiuesit e letërsisë shqipe si dhe dashamirësit e letërsisë janë njoftuar me kanonin letrar të bejtexhinjëve të cilit kanë shkruar jo vetëm në gjuhën shqipe por edhe në gjuhët orientale. Divanet e tyre janë vlerësuar herë si letërsi epigonike herë si letërsi orgjinale. Me të njejtat kritika përballet edhe letërsia e divanit të poeteve boshnjak. E Shqetësuar me këtë, studiuesja boshnjake Amina Šiljak-Jesenković, pas punimeve të dëshmuara në fushën e gjuhësisë për të cilat ka marrë edhe ‘çmimin e veprës më të mire në fushën e shkencës të vitit 2004’ nga ana e shoqatës së botuesve dhe librarive të

Bosnjes, kësaj rradhe me një qasje serioze shkencore trajton mesnevitë e dashurisë në vargjet e poetëve boshnjake të divanit. Duke u nisur nga mendimi se letërsia e divanit ka një tematikë, stilistikë dhe gjuhë universale në çdo gjuhë në të cilën është krijuar dhe duke pasur parasysh se në qendrën e hulumtimeve të studiuesve, komparatistëve dhe historianëve të letërsisë shqiptare do të duhej të gjendej objekti i njejtë i studimit e kemi parë të dobishme që të hedhim një sy në librin e saj me titullin “*Reflektimi i mesnevisë së dashurisë në vargjet e poeteve boshnjak të divanit*”.

Libri përbëhet nga katër tërësi tematike. Në pjesën e parë autorja jep shënime mbi jetën dhe veprat e 16 poeteve të divanit. Personalitetet dhe veprat e tyre i trajton në mënyrë shkencore duke iu referuar burimeve lokale si dhe studiuesve botërore. Në pjesën e dytë flet për tregimin si simbol. Trajton temat e përbashkëta të poeteve të divanit të përdorura në mesnevitë e tyre të dashurisë, siç janë Rrëfimi më i bukur: Jusuf dhe

Zulejha, Mexhnuni dhe Lejla; Dy karakterë të dashurisë: Ferhad dhe Husrev, Skendername etj. Në pjesën e tretë i trajton mesnevitë me frekuencë më të ulur të citimit: Huma dhe Humajun, Suhejl dhe Nevbahar, Hurshid-i Ferahshad, Varka dhe Gylshah, Ferruh dhe Huma. Në pjesën e katërt, pas trajtimit të mesnevive heronjë e të cilave janë qeniet njerëzore të emërtuara me antroponimet të rrethit të tyre kulturore, Amina Shiljak veçanërisht trajton heronjë të cilët mbajnë emra të koncepteve abstrakte siç janë emrat e trupave qiellore (Mihr u Mah, Mihr u Vefa etj.) dhe i quan si të dashuruarit qiellor të ngritur në simbolet. Shpjegon kuptimin e simboleve të “bilbili dhe trëndafili”, “flutur dhe qiri”, “bukuri dhe dashuri”. Para paraqitjes së përfundimit autorja përmyll studimin me disa fjalë mbi prezencën e tregimeve popullore të dashurisë në mesnevitë e korpusit të studimit të saj.

Duke u nisur nga mendimi se ekziston një arhitekst të veprave letrare të cilët shkruajnë për temat e

njejta siç është Mexhnuni me Lejlën, Jusufi me Zulejhën etj., autorja kupton se nuk bëhet fjalë vetëm për një ose më shumë vepra letrare por për një koncept të tërë, një tekst strukturalisht të forte dhe njëkohësisht sipas përmbajtjes krejtësisht të hapur, të papërfunduar (të papërfundueshëm), i cili gjithnjë po ndërlihet, shpjegohet dhe lexohet prej fillimit; një tekst pamjet e të cilit bëhen shenja, semiologjikisht të kompresuara brenda një diskursi tjetër – sikurse minijaturat mahnitëse në botën e artit. Qëllimi i kësaj vepre është të tregojë aluzionin dhe reminishencën (parafrazimin) e përmbajtjeve të mesnevive të shumta të dashurisë si prototekst në format e ndryshme poetike të autorëve boshnjake të divanit.

Autorja kërkon rezultate të këtyre shenjave dhe funksioneve të tyre brenda gjuhës së poezisë së divanit, thotë se përpiket t'i zgjidh dilemat mbi dinamizmin e këtyre shenjave dhe i kërkon ekuivalentet e tyre; të gjejë përgjigje në pyetjen, a bëhet fjalë për ekuivalentet e shenjave

në tregime të tjera, apo për variacionet e ndryshme të tyre, a mund të flitet për një ngjeshje semiotike të emrave të ndryshme të të shënjuarit të njejtë; të gjejë përgjigje në pyetjet lidhur me funksionet të këtyre shenjave të ngjeshura, a bëhet fjalë për shumicën brenda njëshmërisë apo për njëshmëri të reflektuar në shumicë. Pse ekzistojnë me dhjetra vepra të shkruara me titullin e njejtë, a jemi përball një letërsie epigonike, pse poetët vazhdimisht kthehen në një arhitekt që rrjedh nga tradita popullore, transmetimi historik, fiksionit poetik ose prej librave të shenjta? Dhe në fund, këto tregime në të cilat shfaqen heronjtë me emra të njejtë, a janë në fakt pjesë të një hiperteksti me të cillin njeriu përpiqet ta shpjegoj rrugën e pashpjegueshme me fjalë të kërkimit të tij të dashurisë. Nëse po, a është njohur ky koncept apo hipertekst në trashëgimin letrare boshnjake? Meqenëse nuk i gjeti përgjigjet përmes qasjes së formalistave ruse e as me qasjen e strukturalistave thekson se i shfrytëzon teoritë moderne të tekstualitetit.

Autorja me studimin e saj ka zhvendosur kufirin e studimeve të deritanishme në fushën e studimeve të turkologjisë në disa aspekte. Së pari literaturës i qaset në mënyrë sintetike, ka përcaktuar modelin e këtyre poemave narrative, i zbulon shtresat semiotike të tekstit, në metatekst flet për raportin midis tekstit, prototekstit dhe hipertekstit dhe në fund e vënë theksin mbi njëshmërinë e shënjuar me shenjën, simbolin dhe shprehjen letrare, artistike dhe gnostike. Ka cituar më shumë se nëntëdhjetë vepra të studiuesve të ndryshëm të letërsisë së divanit dhe fushave të tjera. Ka përdorur bibliografi mjaftë të pasur që përbëhet nga punimet e autorëve dhe studiuesëve eminentë vendore dhe botërore të fushës së letërsisë, historisë, filozofisë dhe misticizmit. Përmes këtij libri lexuesi mund të sheh se poeti osman nuk ka qenë i përkufizuar me kategorinë e kohës, regjionit, gjuhës dhe etnisë. Kufijtë e tij janë jashtë kasabës, vilajetit, dhe perandorisë së tij; përkatësia e tij shkon madje edhe përtej kufirit të “botës islame”. Ai shkon (nga

Bagdadi e deri në qytetet e Ballkanit) pas prototekstit të njohur, ai e rindërton dhe e përmbledh në simbol. Për këtë autorja thotë “Duke përdorur gjuhën poeti Osman tregon përkatësinë e tij në një ide, në një kod të civilizimit dhe në një poetikë; të

cilën së pari e përvetëson, pastaj mendon për të, e komenton dhe e ndërton vetën si një hallkë në zinxhirin e interpretuesve të një shkolle, veprim ky me të cilin dëshmon përkatësinë e vetë në Njeshmëri”.

Zeqije Xhafçe

Mehmed KICO: 1949 – 2018

Prof. Dr. Mehmed Kico nuk është më, fizikisht, në radhët tona, por *Negjib Mahfuzi, Antara bin Sheddadi, Al-Muvejlihët e Hixhazit* etj..., do ta mbajnë të gjallë kujtimin për Kicon, në mesin jo vetëm të studentëve të tij por edhe në mesin e studiuesve dhe dashamirëve të letërsisë arabe dhe kulturës së orientit në përgjithësi.

Mehmeti u nda nga kjo jetë pas një sëmundje të shkurtër, që nuk e ndau nga puna deri në frymën e fundit. Për këtë na shtyn të besojmë fakti se opinioni shkencor Boshnjak e kanë të freskët artikullin e tij në *Preporod* të 1 prillit, 2018.

Ky mund të mbetet kontributi i tij i fundit, sepse me 20 prill të vitit 2018, pushon së rrahuri zemra fisnike e prof. Dr. Mehmed Kicos. Vdekja e tij la një zbrazëtim të madhe në qarqet shkencore Boshnjake dhe jo vetëm Boshnjake.

Mehmedi kontribuoi edhe në Universitetin e Prishtinës, profesor i gjuhës arabe për studentët që ndiqnin mësimet në gjuhën serbokrate, pasiqë në Universitetin e Prishtinës deri në vitin 1990, mësimi zhvillohej në dy gjuhët: *shqip dhe serbokroatisht*.

Mehmed Kico u lind në vitin 1949, në fshatin Graçanicë, te Bugojno, në Bosnje. Në vendlindje kreu shkollën fillore, në vitin 1963; maturën e në Sarajevë, në Medresen Gazi Husrevbeg, në vitin 1968. Vazhdoi studimet në Universitetin e Beogradit – gjuhë dhe letërsi arabe, në Degën e Orientalistikës, Fakulteti i Filologjisë, ku diplomon në vitin 1974. Në të

njëjtin drejtim, në vitin 1980 mbrojti temën e magjistraturës: **Arabistika u Prilozima za orijentalnu filologiju 1950. do 1975.**

Karrierën Universitare e filloi në Prishtinë, 1980 – 1982, ligjërues i gjuhës arabe në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Tërë jetën ia kushtoi gjuhës arabe. Në vitin 1981 ishte sekretar i Degës së Orientalistikës.

Në periudhën 1982 – 1995, Mehmed Kico punoi përkthyes i gjuhës arabe në disa institucione me renome në fushë të ekonomisë dhe politikës. Ishte përkthyes në takimet ministrore të Organizatës së të Painkuadruarëve. Nga viti 1995 - 2001 punoi ligjërues i gjuhës arabe në Akademinë Pedagogjike në Zenicë. Pas mbrojtjes së doktoratës, në Fakultin e Shkencave Islame (FIN) në Sarajevë, në vitin 2002, temën "Općelingvistička utemeljenja i specifična određenja arapske jezikoslovne znanosti (Përcaktuesit specifikë të gjuhës arabe në formimin e gjuhësisë së përgjithshme), zgjedhet docent kurse në vitin 2008 profesor inordinar për gjuhë arabe në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë.

Ka qenë kryeredaktor dhe anëtarë i redaksisë në: „Alem“; „Preporod“; „Zbornik radova Fakulteta islamskih nauka“; „Beharistan“;

Ka botuar punime profesionale- shkencore në disa revista shkencore, si në: „Studia philologica“, Prishtinë; „Zbornik Filozofskog fakulteta, Prishtinë; „Prilozi za orijentalnu filologiju“, Sarajevo; „Zbornik radova, Fakultet islamskih nauka“ Sarajevo; „Glasnik“ Rijaset Islamske zajednice, Sarajevo; „Preporod“ Rijaset Islamske zajednice, Sarajevo; „Novi Mualim“, Sarajevo; „Znakovi vremena“, Sarajevo; „Hercegovina“, Mostar; „Novi Horizonti“, Zenica; „Behar“ Zagreb; „Zbornik radova nastavnika Akademije“ Zenica; „Beharistan“, Sarajevo.

A. Veprat monografike

1. *Bosanski jezik i Baštinici*, Sarajevo, 2001.
2. *Arapska jezikoslovna znanost*, Sarajevo, 2003.
3. *Pogled u život i djelo Nedžiba Mahfuz*, Sarajevo, 2006.
4. *Ogledi u poetici prevođenja*, Sarajevo, 2010.
5. *Arabistika u „Prilozima za Orijentalnu filologiju“ od 1950. do 1975.* Sarajevo, 2011.
6. *Arapska gramatika u vremenu - od logicizma do strukturalizma*, Sarajevo, 2013.
7. *Islamska književnost između arabizma i arabistike*, Sarajevo, 2015[
8. *Kosmopolitizam Nedžiba Mahfuz - u svjetlu translatologije i komunikologije*, Sarajevo, 2016.
9. *Arapski jezik u prevođenju između Istoka i Zapada*, Sarajevo, 2012.

B. Veprat e përkthyer

1. Mu'nis al-Razzaz, *Al-Ahya' fi al-Bahr al-mayyit*, (Živi u Mrtvome moru), roman, Sarajevo, 1998.
2. Muhammad al-Kangi, *Al-Gawhar al-asna fi taragim žulama' wa šuara' Busna*, (Blistavi dragulj, Životopisi učenjaka i pjesnika iz Bosne) Izabrana djela Mehmeda Handžića, Knjiga 1, Sarajevo, 1999.
3. Nagib Mahfuz, *Tharthara fawq al-Nil*, (Razgovori na Nilu), Sarajevo 2000.
4. Muhammad 'Umhazun, *Manhag dirasa al-tarik al- 'islami*, (Koncept izučavanja islamske historije), Sarajevo, 2001.
5. Nagib Mahfuz, *Layali alf layla*, (U 1000 noći), Preporod, Travnik, 2001.
6. *Antar sin Šedadov (Antar ibn Šaddad, I-II)*, Sarajevo, 2002.

7. Ahmed Behdžet, *Busna wa al-Harsak - Ğarima al-'asr*, (*Bosna i Hercegovina - Zločin stoljeća*) Sarajevo, 2004.
8. Nagib Mahfuz, *Han al-Halili*, (Kvart Han al-Halili), Sarajevo, 2005.
9. Muhammed Rewwas Qal'ahdži, *Dirasa tahliliyya li šahsiyya al-Rasul Muhammad s.a.v.s. min hilal siratih al-šarifa*, (Ličnost Posljednjeg Allahovog poslanika...) Sarajevo – Zenica, 2006.
10. Nagib Mahfuz, *Al-Liss wa al-kilab*, (Lopov i psi), Sarajevo, 2005.
11. Safwat Kalilufiš, *Al-Imam Abu Bakr al-Razi al-Gassas wa manhaguh fi al-tafsir*, (Metodologija tumačenja Kur'ana u hanefijskime mehebu) Sarajevo, 2004.
12. Yusuf Ramitš, *Usra Al-Muwaylihi wa alaruha fi al-adab al-'arabi al-hadith*. (Moderna arapska književnost - Porodica Al-Muwaylihi i njeni uticaji u književnosti Sarajevo, 2003.
13. Nagib Mahfuz, *Al-Qahira al-gadida*, (Novi Kairo), Sarajevo, 2005.
14. Nagib Mahfuz, *Miramar*, (Pansion Miramar), Sarajevo, 2005.
15. Ibn Kajjim el-Đevzije, *Hikma al-ibtala'*, (Smisao kušnje), Sarajevo, 2006.
16. Svjetska unija islamskih učenjaka, *Islamska povelja* (u knjizi Rezolucija Islamske zajednice u Bosni i Hercegovini o tumačenju islama i drugi tekstovi, str. 61-194.), Sarajevo, 2006.
17. Nagib Mahfuz, *Al-Maraya*, (Ogledala), Sarajevo, 2008.
18. Nagib Mahfuz, *As-Sayyid al-muhtaram*, (Poštovani gospodin), Sarajevo, 2008.
19. Nagib Mahfuz, *Al-Hubbu tahta l-matari*, (Ljubav na kiši), Sarajevo, 2008.
19. Abdu l-Halim Mahmud, *Tarbiyatu n-naši'i l-muslimi*, (Osnovi islamske pedagogije), Novi Pazar, 2008.

19. Fet-hulah Gulen, Nazariyyatu t-tatawwuri wa haqiqatu l-kalqi, (Teorija evolucije i istina o stvaranju) Sarajevo, 2010.

20. Fet-hulah Gulen, *Adwa'un qur'aniiyyatun fi sama'i lwi*(dani), Kur'anska svjetlost na nebu spoznaje), Sarajevo, 2011.

Kujtimi për prof. Dr. Mehmed Kicon nuk do të zbehet asnjëherë. Për këtë garanca më e fortë janë veprat e përmendura dhe qindra kontribute tjera nëpër revistat shkencore: *Prilozi za orijentalnu filologiju - Sarajevo*, *Arhiv Hercegovine - Mostar*, *Glasnik Rijasete islamske zajednice u Bosni i Hercegovini - Sarajevo*, *Anali Gazi Husrevbegove Biblioteke - Sarajevo*, *Zbornik Fakulteta Islamskih Nauka - Sarajevo*, *Novi horizont - Zenica*, e gjetiu, që ua la breznive që vinë.

Feti Mehdiu,

Prishtinë (mars, 2019)

Qemajl Morina (1951 – 2019)

Pas një sëmundje te rende dhe te gjatë, u nda nga jeta shoku dhe kolegu ynë Qemajl Morina, mbrëmjen e së Premtes, me 22.02.2019 , për tu përcjellur nga një masë e madhe njerëzish me 23.02.2019 ne vendlindjen e tij.

Qemajli tërhoqi vëmendjen e shumë njerëzve të rrethit shqiptar në Kajro, qoftë të kolonisë ose të studentëve, gjatë studimeve të tij në studimet post universitare në Universitetin e Kajros , me seriozitetin e tij në hulumtime shkencore nëpër arkivat e Kajros për historinë kombëtare si dhe me punën e tij në lëmin e specializimit .

Po ashtu, me të kthyer në Kosovë, është çmua lartë nga të gjithë gjatë punës së tij në vende të ndryshme deri ne pensionimin e tij në vitin 2016.

Qemajl Morina u lind në 03.01.1951 në fshatin Hodonofc, komuna e Kamenicës, ku edhe kreu shkollën fillore për të vazhdua në Prishtinë në Medresen e Mesme Alaudin, ku u shoqëruam disa vjet atje.

Pas përfundimit te shkollës së mesme, u regjistrua ne Universitetin Um Durman në Kartum të Sudanit, në Fakultetin e gjuhës dhe letërsisë arabe, ku edhe i përfundoi studimet universitare ne vitin 1976.

Nga Sudani ai u transferua në Universitetin e Kajros në studimet post universitare ne lëmin e fonetikes. Ai e mbrojti temën e magjistraturës me temën “Studime kontrastive në mes te gjuhës arabe dhe asaj shqipe në lëmin e fonologjisë” për të ciën mora lëvdata nga mentori i tij profesori i

njohur egjiptian Mahmud Fehmi Hixhazi.

Gjatë viteve 1980-1990 ai punoi përkthyes në ekipin medicinal Kosovar në Bengazi te Libisë Pas kthimit në Kosovë ai punoi së pari gjatë viteve 1990-1992 ligjërues i gjuhës arabe në Degën e Orientalistikës – Universiteti i Prishtinës, pastaj kaloi ne Fakultetin e Studimeve Islame si ligjërues i gjuhës arabe dhe prodekan i Fakultetit . Nga viti 2001 – 2016 ai ishte kryeredaktor i revistës edukative shkencore “Dituria Islame.

Qemajl Morina njihej si hulumtues i përkushtuar dhe serioz në arkivat e Egjiptit dhe të Sudanit dhe te Libisë, filloi ti botonte punimet e tij që nga faza e magistraturës në Kajro ,artikuj të shumte në gazetata dhe revistat e Kosoves si “Rilindja”, “Zëri”, ”Përparimi”, dhe “Jeta e Re” dhe tjera. Ai mori pjese ne shume konferenca ndërkombëtare si ne Shqipëri, Egjipt Jordani etj.

Përveç tjerash ai botoi disa libra në gjuhën shqipe me rendësi te vecantë:

1. Hoxh Kadri Gjilani ,mendimtar Islam ,ne vitin 2000
2. Lidhja e Prizrenit ne shtypin Egjiptian 1878- 1881
3. Fjalor i shprehjeve fetar (islame, krishtere dhe hebreje).

Përveç kësaj ai u mor edhe me përkthimin e letësisë arabe në gjuhën shqipe.Prej veprave më të njohura të kësaj letërsie ai e përktheu romanin e shkrimtarit të njohur sudanez El-Tajib Saleh "Koha e shpërnguljes për në veri", i cili u botua në Prishtinë (Koha 2012).

Gjatë viteve sa punuam bashkë , ndihesha i privilegjuar. Gjithnjë i qeshur dhe me libra e artikuj për te argumentua çdo fjale të thënë e çdo ide te

lansuar, ose për te dëshmuar te thënat dhe të bëmat e atyre që nuk e donin paqen.

Vlen të shënohet këtu vizita në SHB 23 Prill-05 Maj ,te organizuar me ftese të DSHBA-ve nën organizimin e ambasadës amerikane në Prishtinë,dhe takimi me z.Eliot Engel, mikun i madh të popullit shqiptar dhe paraqitja e qëndrimeve paqësore të popullatës shqiptare në përgjithësi, e të atyre të besimit islam në veçanti.

Qemajlin e vizitova edhe kohëve të fundit. Buzëqeshjen e kishte si dikur . Biseduam gjatë dhe thua se kuptoheshim me shumë pak fjalë.

Ejup Ramadani

POETRY UNDER THE PROPHET'S MANTLE

Esad Duraković *

Poetry and the mantle! The Prophet's covering of the poet by the mantle (in the very essence of things, it was not the poet who was covered, but his work) is a special kind of poetological affirmation that was indicated in the poem recited by Zuhayr Ibn Abi Sulma (520-609). The Prophet silently and with pleasure listened to the poem, which was recited to him in the context of a merciless confrontation between the *Qur'ān* and poetry precisely in the domain of poetics and aesthetics, in a context that took away the right of poetry to the ideological aspect upon which it had rested until then. Yet the act of mantling the poem promoted a new poetics that would dominate the literary empire formed afterward. The later history showed the immense protective benefit of the Prophet's Mantle.¹

* Member of academies in Sarajevo, Cairo, Damascus and Amman, Professor of Arabic language and literature during 1975-2017 in Oriental Studies Departments' in Pristina and Sarajevo.

This is a chapter from his last book published in Bosnian (Sarajevo 2018) under the titull "Klasicno Pjesništvo na arapskom, perzijskom i turskom jeziku- Poetoloski pristup" (Classic Poetry in Arabic, Persian and Turkish languages- A Poetological Approach)

